KOMUNA GLLOGOC
GLLOGOC MUNICIPALITY
PRANUAR 13 / 07 / 2026
Nj. Org. | Numër | Shtojca | Vlera
01 | 05216 | 1- 28264

**Republika e Kosovës**
Republika Kosova – Republic of Kosovo
**Komuna e Drenasit**
Opština Drenas –Municipality of Drenas



# RAPORTI GJASHTËMUJOR I PUNËS

## Janar-Qershor 2026

Korrik, 2026

Përmbajtja:

**Fjala e Kryetarit** ........ 3
**Zyra për Komunikim me Publikun** ........ 7
**Njësia e Auditimi të Brendshëm** ........ 10
**Njësia për të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore** ........ 13
**Zyra Ligjore** ........ 16
**Zyra për Integrime Evropiane** ........ 18
**Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim** ........ 22
**Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore** ........ 24
**Drejtoria për Administratë të Përgjithshme** ........ 26
**Drejtoria për Buxhet dhe Financa** ........ 36
**Drejtoria Komunale e Arsimit** ........ 40
**Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë** ........ 51
**Drejtoria për Zhvillim Ekonomik** ........ 55
**Drejtoria për Infrastrukturë Publike** ........ 58
**Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale** ........ 59
**Drejtoria e Inspeksionit** ........ 63
**Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit** ........ 66
**Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural** ........ 69
**Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport** ........ 70
**Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë** ........ 74

## Fjala e Kryetarit

Të nderuar qytetarë të Komunës së Drenasit,
Të nderuar anëtarë të Kuvendit të Komunës,
Të nderuar drejtorë të drejtorive komunale, zyrtarë komunalë, përfaqësues të institucioneve dhe bashkëpunëtorë,

Me përgjegjësi të plotë institucionale dhe me respekt të veçantë për qytetarët e Komunës së Drenasit, paraqes para jush Raportin e punës gjashtëmujore të Komunës së Drenasit për periudhën janar–qershor 2026.

Ky raport është pasqyrë e punës, angazhimit dhe përgjegjësisë së institucioneve komunale gjatë gjashtë muajve të parë të vitit. Ai përmbledh aktivitetet, shërbimet, projektet, sfidat dhe rezultatet e arritura nga Zyra e Kryetarit, drejtoritë komunale, njësitë profesionale dhe sektorët administrativë, të cilët kanë qenë në shërbim të qytetarëve dhe në funksion të zhvillimit të komunës sonë.

Gjatë kësaj periudhe, qeverisja komunale është udhëhequr nga parimet e përgjegjshmërisë, transparencës, ligjshmërisë, efikasitetit dhe përkushtimit ndaj interesit publik. Synimi ynë ka qenë i qartë: të ofrojmë shërbime më të mira për qytetarët, të avancojmë projektet zhvillimore, të rrisim cilësinë e administratës, të forcojmë llogaridhënien dhe të vazhdojmë investimet që ndikojnë drejtpërdrejt në jetën e përditshme të qytetarëve tanë.

Në fushën e transparencës dhe komunikimit publik, Komuna ka vazhduar publikimin e vendimeve, dokumenteve, njoftimeve, konkurseve, materialeve të Kuvendit Komunal dhe aktiviteteve të tjera me interes publik. Janë trajtuar kërkesat për qasje në dokumente publike, janë përcjellë aktivitetet komunale dhe është mbajtur tubimi publik me qytetarë në përputhje me afatet ligjore. Transparenca nuk është vetëm obligim ligjor; për në është kulturë e qeverisjes dhe mënyrë për të ndërtuar besim me qytetarin.

Në kuadër të auditimit të brendshëm, janë realizuar auditimet e planifikuara për gjashtëmujorin e parë, janë shqyrtuar raportet përkatëse dhe janë dhënë rekomandime profesionale për përmirësimin e menaxhimit komunal. Rekomandimet e auditimit janë trajtuar me seriozitet nga menaxhmenti komunal, sepse kontrolli i brendshëm, menaxhimi i mirë financiar dhe zbatimi i procedurave janë bazë për një administratë të qëndrueshme, të përgjegjshme dhe të besueshme.

Në administratë, është vazhduar puna për ofrim të shërbimeve efikase dhe të shpejta për qytetarët. Sektori i Gjendjes Civile, Qendra për Shërbim të Qytetarëve, arkiva, prokurimi, teknologjia informative dhe shërbimet e përbashkëta kanë kryer një volum të madh pune. Gjatë kësaj periudhe janë lëshuar mijëra dokumente të gjendjes civile dhe janë trajtuar mijëra lëndë në Qendrën për Shërbim të Qytetarëve, duke dëshmuar përkushtimin e administratës komunale për t'iu përgjigjur kërkesave të qytetarëve me kohë, me profesionalizëm dhe me përgjegjësi.

Në fushën e financave dhe buxhetit, Komuna ka vazhduar zbatimin e detyrave në përputhje me legjislacionin në fuqi, me përgjegjësi ndaj parasë publike dhe me kujdes të shtuar në menaxhimin e të hyrave dhe shpenzimeve. Janë zhvilluar aktivitete të rëndësishme në tatimin në pronë, në

planifikimin buxhetor dhe në raportimin financiar, ndërsa dëgjimet buxhetore dhe përfshirja e qytetarëve në procesin e planifikimit mbeten pjesë e rëndësishme e qeverisjes sonë.

Në arsim, angazhimi ynë ka qenë i përqendruar në përmirësimin e kushteve për nxënësit, mësimdhënësit dhe institucionet arsimore. Arsimi është një nga shtyllat kryesore të zhvillimit të komunës, prandaj investimi në shkolla, në cilësi të mësimdhënies, në siguri, në infrastrukturë dhe në aktivitete edukative mbetet prioritet i përhershëm. Çdo përmirësim në arsim është investim në të ardhmen e Drenasit.

Në shërbime publike dhe emergjencë, është punuar në mirëmbajtjen e hapësirave publike, në menaxhimin e shërbimeve komunale, në reagimin ndaj rasteve emergjente dhe në adresimin e kërkesave të qytetarëve. Kjo fushë është ndër më të ndjeshmet, sepse lidhet drejtpërdrejt me cilësinë e jetës së përditshme. Për këtë arsye, kërkesa jonë ndaj sektorëve përgjegjës ka qenë dhe mbetet: reagim i shpejtë, punë në terren dhe koordinim i vazhdueshëm.

Në zhvillimin ekonomik, Komuna ka vazhduar angazhimin për të krijuar kushte më të mira për bizneset, për investime dhe për zhvillim lokal. Ekonomia lokale nuk forcohet vetëm me projekte të mëdha, por edhe me mbështetje të vazhdueshme për ndërmarrësit, fermerët, prodhuesit, të rinjtë dhe iniciativat që krijojnë vende pune e gjallërojnë ekonominë e komunës.

Në infrastrukturë publike, janë trajtuar dhe proceduar projekte që kanë të bëjnë me rrugë, trotuare, kanalizime, mirëmbajtje dhe përmirësim të kushteve infrastrukturore në vendbanime. në jemi të vetëdijshëm se kërkesat e qytetarëve në këtë fushë janë të mëdha dhe të arsyeshme. Për këtë arsye, projektet infrastrukturore do të vazhdojnë të realizohen sipas prioriteteve, mundësive buxhetore dhe nevojave reale të qytetarëve.

Në shëndetësi dhe mirëqenie sociale, prioritet ka qenë ofrimi i shërbimeve më cilësore shëndetësore dhe kujdesi për kategoritë që kanë më së shumti nevojë për mbështetjen e institucionit. Një komunë e mirë nuk matet vetëm me investime kapitale, por edhe me mënyrën se si i qëndron pranë qytetarit në ditët kur ai ka më së shumti nevojë për institucionin.

Në inspektim, urbanizëm dhe mbrojtje të mjedisit, është vazhduar puna për zbatimin e ligjit, mbrojtjen e hapësirës publike, trajtimin e kërkesave të qytetarëve dhe zhvillimin e planifikuar të komunës. Zhvillimi urban duhet të jetë i qëndrueshëm, i rregullt dhe në përputhje me interesin publik. Drenasi duhet të zhvillohet, por ky zhvillim duhet të ndodhë me plan, me ligj dhe me përgjegjësi.

Në bujqësi dhe zhvillim rural, Komuna ka vazhduar angazhimin për përkrahjen e fermerëve dhe zhvillimin e zonave rurale. Fermeri i Drenasit është pjesë e rëndësishme e ekonomisë familjare dhe lokale, prandaj mbështetja për bujqësinë nuk është vetëm ndihmë sektoriale, por mbështetje për familjen, prodhimin vendor dhe jetën në fshat.

Në kulturë, rini dhe sport, janë realizuar aktivitete që forcojnë jetën kulturore, sportive dhe rinore në komunë. Drenasi ka rini aktive, sportistë të dalluar, krijues, artistë dhe shoqëri civile që meritojnë hapësirë dhe përkrahje. Investimi në kulturë, rini dhe sport është investim në energjinë pozitive të komunës sonë.

Në gjeodezi, kadastër dhe pronë, është vazhduar puna në trajtimin e lëndëve, ofrimin e shërbimeve profesionale dhe administrimin e çështjeve pronësore. Kjo fushë kërkon saktësi, përgjegjësi dhe kujdes të veçantë, sepse lidhet me të drejtat pronësore të qytetarëve dhe me zhvillimin e projekteve publike.

Të nderuar qytetarë,

Gjashtëmujori i parë i vitit 2026 dëshmon se Komuna e Drenasit ka vazhduar punën në shumë fusha njëkohësisht: në administratë, arsim, shëndetësi, infrastrukturë, financa, bujqësi, kulturë, rini, sport, transparencë, zhvillim ekonomik dhe shërbime publike. Kjo punë nuk do të ishte e mundur pa përkushtimin e zyrtarëve komunalë, drejtorive, Kuvendit Komunal, institucioneve partnere dhe qytetarëve që me kërkesa, propozime dhe vërejtje kontribuojnë në përmirësimin e qeverisjes lokale.

Natyrisht, krahas punës dhe rezultateve të arritura, Komuna e Drenasit është përballur edhe me sfida të rëndësishme, disa prej të cilave nuk janë të reja dhe nuk lidhen vetëm me këtë periudhë raportuese. Një nga sfidat më të mëdha, e cila tash e disa vite me radhë po e rëndon buxhetin e komunave në përgjithësi, është barra financiare që buron nga pagesat dhe obligimet e krijuara nga kontratat kolektive.

Këto kontrata, të lidhura vite më parë në nivel qendror, kanë prodhuar pasoja të drejtpërdrejta për buxhetet komunale, duke krijuar detyrime financiare të paplanifikuara dhe duke ndikuar në aftësinë e komunave për të realizuar projekte kapitale. Për vite me radhë, komunat janë detyruar të përballen me ekzekutime përmbarimore dhe pagesa që nuk kanë qenë të planifikuara në mënyrë të rregullt në buxhetet komunale, duke bërë që mjetet e parapara për investime publike të orientohen në mbulimin e këtyre obligimeve.

Kjo gjendje ka pasur ndikim të drejtpërdrejtë në zhvillimin lokal. Në vend që një pjesë më e madhe e buxhetit të përdorej për rrugë, kanalizime, trotuare, shkolla, hapësira publike, ndriçim, infrastrukturë sportive apo projekte të tjera kapitale, komunat janë detyruar të bartin një barrë financiare që nuk është krijuar nga vendimmarrja aktuale komunale. Për pasojë, janë penalizuar jo vetëm institucionet komunale, por mbi të gjitha qytetarët, të cilët me të drejtë presin realizimin e projekteve të planifikuara.

Komuna e Drenasit, edhe përballë kësaj sfide shumëvjeçare, ka vazhduar të menaxhojë buxhetin me kujdes, të ruajë stabilitetin financiar, të respektojë obligimet ligjore dhe të angazhohet që projektet kapitale të mos ndalen. Megjithatë, është e rëndësishme të thuhet qartë se barra e kontratave kolektive ka qenë dhe mbetet një nga faktorët që ka kufizuar mundësitë buxhetore të komunave dhe ka ndikuar në dinamikën e realizimit të investimeve publike.

Kjo çështje kërkon trajtim serioz institucional në nivel vendi. Komunat nuk duhet të lihen të vetme përballë pasojave financiare të obligimeve të krijuara nga marrëveshje të mëhershme të nivelit qendror. Zgjidhja e kësaj sfide do të ndihmonte drejtpërdrejt në lirimin e mjeteve për investime kapitale dhe në përshpejtimin e zhvillimit lokal, në të mirë të qytetarëve.

Pavarësisht këtyre vështirësive, Komuna e Drenasit ka vazhduar të punojë me seriozitet, me planifikim dhe me përkushtim. Ka ende kërkesa që presin zgjidhje, projekte që kërkojnë më

shumë kohë, procedura që duhet të përshpejtohen dhe nevoja që tejkalojnë mundësitë e menjëhershme buxhetore. Por ajo që mund të them me përgjegjësi është se Komuna e Drenasit do të vazhdojë të jetë e përkushtuar në adresimin e këtyre nevojave, me rend, me prioritet dhe me përgjegjësi institucionale.

Për gjashtëmujorin e dytë të vitit 2026, fokusi ynë do të jetë në përshpejtimin e realizimit të projekteve, rritjen e efikasitetit të shërbimeve, forcimin e llogaridhënies, përmirësimin e komunikimit me qytetarët dhe përgatitjen e planeve zhvillimore për periudhën e ardhshme.

Drenasi është komunë e punës, e sakrificës, e historisë, e zhvillimit dhe e njerëzve të përkushtuar. Për mua, si Kryetar i Komunës, shërbimi ndaj qytetarëve të Drenasit është përgjegjësi e lartë dhe obligim i përditshëm.

Duke ju falënderuar për besimin, bashkëpunimin dhe kontributin tuaj, ju siguroj se Komuna e Drenasit do të vazhdoj të punojë me përkushtim, me transparencë dhe me përgjegjësi për çdo qytetar dhe për çdo vendbanim të komunës sonë.

Faleminderit!

## Zyra për Komunikim me Publikun

*Raporti i punës Janar – Qershor 2026*

| Nr. rendor | Objektiva | Aktiviteti | Afati | Bartës i aktivitetit |
|---|---|---|---|---|
| -I- | **Rritja e transparencës dhe mundësive të reja për komunikim** | 1. Raporti për periudhën Janar-Qershor i Kryetarit për vitin 2026, | Korrik 2025 | Zyra për Komunikim me Publikun |
| | | 2. Ofrimi i qasjes në Dokumente publike, | 22 kërkesa për qasje në dokumente publike, 19 të qasshme, 3 prej tyre ende në proces. | Zyra për Komunikim me Publikun |
| | | 3. Raportimi për Transparencë dhe përmbushjen e obligimeve për ueb faqen zyrtare, në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, | Raporti është dërguar në qershor 2025. | Zyra për Komunikim me Publikun |
| | | 4. Tubimi i parë me publikun | Më 25 Qershor 2026 – tubimi me publikun ka përfunduar brenda afatit ligjor dhe njoftimi është bërë 14 ditë para mbajtjes së tubimit. | ZKP në bashkëpunim me drejtori dhe zyre komunale |
| | | 5. Treguesit e transparencës (Performanca komunale MAPL, OJQ), | Gjatë periudhës raportuese në SIMPK, janë futur të gjitha të dhënat që kanë qenë nga Zyra, ku është mbuluar fusha "Përgjegjshmëria Komunale" | ZKP |
| | | 6. Publikimi i vendimeve, procesverbaleve të Kuvendit të Komunës dhe materialeve të Kuvendit e Komitetit. | Pas kthimit të ligjshmërisë nga MAPL, të gjitha vendimet janë publikuar në ueb faqen zyrtare të komunës | Sekretaria e Kuvendit përmes ZKP-së |
| | | 7. Publikimi i vendimeve dhe urdhëresave të kryetarit të Komunës dhe gjitha dokumenteve të Komunës, duke përfshirë të prokurimit, konkurseve, njoftimeve dhe dokumenteve të tjera në ueb faqen zyrtare, | Të gjitha dokumentet e këtij aktiviteti, janë publikuar në ueb faqe dhe lehtë mund të vërtetohen. | ZKP dhe zyre të tjera komunale |

| Nr. rendor | Objektiva | Aktiviteti | Afati | Bartës i aktivitetit |
|---|---|---|---|---|
| | | 8. Publikimi i lajmeve/njoftimeve, shpalljeve, konkurseve dhe çdo informatë tjetër që ka të bëjë me informimin e qytetarëve në ueb faqe dhe rrjetin zyrtar social-Facebook | Të gjitha këto të dhëna janë publikuar në ueb faqen zyrtare dhe lehtë janë të qasshme | ZKP |
| | | 9. Përcjellja e të gjitha aktiviteteve komunale | Aktivitetet e Komunës janë përcjellë e publikuar sipas afateve. | ZKP |
| | | 10. Dhënia e deklaratave për media dhe dërgimi i komunikatave të ndryshme | Për secilën media që ka kërkuar deklaratë, qoftë me shkrim, në formën elektronike apo në TV, janë dhënë. | ZKP |
| | | 11. Mirëmbajtja dhe azhurnimi i ueb faqes zyrtare të Komunës dhe rrjetit social Facebook | Vazhdimisht është populluar me të dhënat e kërkuara ueb faqja. | ZKP |
| | | 12. Përcjellja e mbledhjeve të Bordit, KKSB-së, KPF dhe Kuvendit të Komunës | Në këto mbledhje, ka prezantuar çdo herë Zyra për Komunikim me Publikun | Komuna-KK-KPF-ZKP |
| | | 13. Ofrimi i fotografive profesionale gjatë takimeve, eventeve, realizimin e projekteve si dhe krijimi i video mesazheve të shkurtra për qytetarët | Zyra për Komunikim me Publikun ka fotografin e zyrës, i cili në mënyrë profesionale ka realizuar detyrat e tij. | ZKP |
| | | 14. Publikimi i gjitha dokumenteve të prokurimit në ueb faqen zyrtare | 5 kategoritë e prokurimit, nga njoftimi për dhënie të kontratës, deri të nënshkrimi i kontratës, janë publikuar në ueb faqen zyrtare të komunës. | Zyra e Prokurimit dhe ZKP |
| | **Rritja e pjesëmarrjes së qytetarëve** | 1. Konsultimi me qytetarë dhe grupe të interesit para hartimit të politikave publike | Gjatë kësaj periudhe raportuese, nuk është mbajtur ende asnjë konsultim publik. | Drejtoritë, ZKP |

| Nr. rendo r | Objektiva | Aktiviteti | Afati | Bartës i aktivitetit |
|---|---|---|---|---|
| **-II-** | **në hartimin e politikave publike** | 2. Konsultimi me qytetarë gjatë planifikimit të buxhetit, (KAB dhe buxhetin) | Në muajin Maj 2026, sipas planit të punës, është mbajtur një dëgjim buxhetor dhe janë publikuar të gjitha detajet në ueb faqe të komunës, nga kalendari i dëgjimeve, thirrjes, draft-KAB-in, njoftimet për tubim, mbajtjen e dëgjimeve, hartimi i procesverbali dhe raporti i dëgjimeve si dhe publikimi i tyre në ueb faqen zyrtare. | ZKP, Drejtoria për Buxhet dhe Financa |
| | | 3. Përcjellja e objektivave që dalin nga Plani Komunal i Veprimit për Transparencë dhe Rregullores Komunale për Transparencë. | Në kuadër të Planit të Veprimit, janë përcjellë të gjitha aktivitetet që dalin nga ky dokument. | ZKP |

## Njësia e Auditimi të Brendshëm

Sipas nenit 19, pika 2.1 të Ligjit nr. 06/L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike si dhe në pajtim me Rregulloren QRK nr. 01/2019, Komuna ka të themeluar Njësinë e Auditimit të Brendshëm në vartësi të drejtpërdrejtë të Udhëheqësit të Subjektit të Sektorit Publik. Poashtu në pajtim me nenin 20 të këtij Ligji është i formuar edhe Komiteti i Auditimit të Brendshëm.

Njësia e Auditimit të Brendshëm në fund të vitit 2025, ka hartuar dhe aprovuar para Komitetit të Auditimit të Brendshëm Planin Strategjik të zhvillimit të aktiviteteve audituese për vitet 2026 - 2028 si dhe duke u bazuar në këtë Plan, ka miratuar edhe Planin vjetor të Punës për vitin 2026.

Bazuar në Planin vjetor të punës së Njësisë së Auditimit të Brendshëm për vitin 2026 janë planifikuar të kryhen gjithësej shtatë auditime. Në gjysëmvjetorin e parë ishin planifikuar të kryhen katër auditime të cilat janë kryer në tërësi si dhe janë finalizuar raportet.
Njësia e Auditimit të Brendshëm gjatë këtij gjashtëmujori ka përmbushur në tërësi Planin vjetor të punës duke kryer të gjitha auditimet e parapara me këtë Plan.

Raportet e finalizuara nga Njësia e Auditimit të Brendshëm janë shqyrtuar nga ana e Komitetit të Auditimit të Brendshëm në dy mbledhjet e rregullta të mbajtura nga ky Komitet në baza tremujore.
Njësia e Auditimit të Brendshëm ka ndërmarrë qasje gjithpërfshirëse dhe profesionale për ofrimin e rekomandimeve të dobishme për menaxhmentin e komunës
Gjatë këtij gjashtëmujori janë dhënë një numer i rekomandimeve dhe shumica prej tyre janë implementuar ku nga ana e menaxhmentit janë ndërmarrë 17 aktiviteteve për adresimin e drejtë dhe me kohë të këtyre rekomandimeve.

*Llojet e detyrave të auditimit të realizuara gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2026*

| Nr | Objektivat e detyres: Të arrihet se: | Aktiviteti | Fusha | Afati | Bartes i aktivitetit |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | -Aprovimi i Planit Strategjik për vitet 2026-2028.<br>- Aprovimi i Planit Vjetor të Punës së Njësisë së Auditimit të Brendshëm për vitin 2026.<br>- Aprovimi i Raportit të Gjashtëmujorit të Dytë të vitit 2025.<br>- Aprovimi i Raportit vjetor të Njësisë së Auditimit të Brendshëm për vitin e kaluar Fiskal 2025. | Plani Strategjik 2026-2028, dhe Plani vjetor për vitin 2026, Pregaditja e Raporteve të punës për gjashtëmujorin e dytë dhe Raportit vjetor për vitin 2025 | Të gjitha Drejtoratet | Janar, 2026 | Njësia e Auditimit të Brendshëm, Komiteti i Auditimit të Brendshëm |

| Nr | Objektivat e detyres:<br>Të arrihet se: | Aktiviteti | Fusha | Afati | Bartes i aktivitetit |
|---|---|---|---|---|---|
| 2 | -Identifikimi dhe regjistrimi i duhur i pasurive.<br>-Menaxhimi dhe ruajtja efektive e pasurive.<br>-Mirëmbajtja e saktë e të dhënave për pasuritë përmes mbajtjes sistematike të regjistrit të pasurive.<br>-Harmonizimi i të dhënave mbi pasuritë me kontabilitetin e sektorit publik në përputhje me obligimet ligjore.<br>-Tjetërsimi dhe zhvendosja e pasurive përmes një procesi transparent. | Auditimi: Menaxhimi me Pasuritë jofinanciare të komunës. | Drejtorati i Financave, Zyrtari i pasurive, Zyrtarët pranues | Shkurt, 2026 | Njësia e Auditimit të Brendshëm |
| 3 | - Rishiqimi i bazës ligjore dhe organizimit përkatës për inkasimin e të hyrave vetanake;<br>- Mbledhja, depozitimi dhe evidencat e të hyrave vetanake të bëhen me kohë dhe në shuma të sakta.<br>- Planifikimi i duhur i të hyrave vetanake nga këto sektore të Komunës.<br>- Sigurimi i barazimeve të të dhënave në lidhje me mbledhjen e të hyrave nga këta sektorë;<br>- Faturimet e rregullta dhe të sakta të të hyrave të arkëtueshme; | Auditimi: Procesi i mbledhjes së të hyrave vetanake nga sektorët e Administratës, Shëndetësisë dhe Arsimit. | Drejtorati i Administratës, Drejtorati i Shëndetësisë dhe Drejtorati i Arsimit. | Mars, 2026 | Njësia e Auditimit të Brendshëm |
| 4 | -Shqyrtimi i Raporteve të Auditimit të kryera gjatë tremujorit të parë të vitit 2026 | Takimi i tremujorit të parë të vitit 2026 | Njësitë e audituara | Prill, 2025 | Njësia e Auditimit të Brendshëm, Komiteti i Auditimit. |
| 5 | - Plani për rekrutimin e punëtorëve të rinj.<br>- Autorizimi i Konkurseve për rekrutim.<br>- Shpalljet publike në pajtim me Legjislacion që rregullon këtë çështje.<br>- Emërimi i Komisioneve bëhet në pajtim me rregullativen ligjore në këtë fushë.<br>- Hartimi i kritereve, testimi dhe intervistimi të bëhen në mënyrë të paraparë ligjore.<br>- Nënshkrimi i kontratave të punës/Akt emërimi të bëhet në pajtim me rregullat ligj.<br>- Lëvizja/transferimi i të punësuarve të bëhet sipas procedurës së mirëfilltë.<br>- Pushimet vjetore, pushimet e lehonisë, pushimet pa pagesë dhe pushimet e përdëllimit të ipen në pajtim me Rregullativen ligjore në fuqi.<br>-Kompenzimi i lehonave, kompenzimi i shpërblimeve jubilare, dhe kompenzimet tjera bëhen në pajtim me Rregullativen ligjore.<br>-Regjistrat e listës së pagave të ofrojnë informata të sakta, komplete dhe aktuale. | Auditimi: Menaxhimi me resurse humane në Administraten e Përgjithshme, Sektorin e Shëndetësisë dhe ate të Arsimit gjatë vitit 2025 dhe tremujorit të parë të vitit 2026. | Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në nivel komunal | Prill - Maj 2026 | Njësia e Auditimit të Brendshëm, |

| Nr | Objektivat e detyres:<br>Të arrihet se: | Aktiviteti | Fusha | Afati | Bartes i aktivitetit |
|---|---|---|---|---|---|
| | -Dosjet personale të të punësuarve të jenë të organizuara dhe të mirëmbajtura si duhet.<br>- Ekzaminimi i kontrolleve në lidhje me vijueshmërinë e punonjësve në punë. | | | | |
| 6 | - Shpërndarja e faturave dhe njohtimi i tatim paguesve me kohë.<br>- Zvogëlimi i vlerës së të arkëtueshmeve.<br>- Ka Komision të shqyrtimit të ankesave.<br>- Ka bazë ligjore dhe organizim të proceseve për mbledhjen e të hyrave.<br>-Ka azhuritet në mbledhje, dhe deponim.<br>-Ekziston planifikim vjetor i të hyrave.<br>-Ka ndarje të duhur të detyrave.<br>-Transakcionet regjistrohen me kohë dhe shumë të duhur. | Auditimi: Të hyrat vetanake nga Tatimi në Pronë. | Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Sektori i Tatimit në Pronë. | Maj-Qershor | Njësia e Auditimit të Brendshëm |
| 7 | -Shqyrtimi i Raporteve të Auditimit<br>- Shqyrtimi i raporteve Gjashtëmujore për NJQHAB,<br>- Shqyrtimi i shkallës së implementimit të rekomandimeve të dhëna gjatë Gjashtëmujorit të parë 2026. | Njësitë e audituara | Gjashtë mujori i parë 2026. | Qershor 2026 | Njësia e A.B, Komiteti i Auditimit të Brendshëm |

## Njësia për të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore

*Raporti Janar – Qershor 2026*

| Nr. rendor | Objektiva | Aktiviteti | Afati | Bartës i aktivitetit |
|---|---|---|---|---|
| -I- | Implementimin e ligjeve vendore që janë në funksion të të drejtave të njeriut, por edhe konventave ndërkombëtare që zbatohen drejtëpërdrejtë në Kushtëtutën e Republikës së Kosovës | 15. Përpilojmë Raporte narrative tre mujore, gjashtë mujore dhe vjetore të punës. | Raportet iu dorëzohen ABGJ, MAPL, ZQM | Njesia për të Drejta të Njeriut dhe Barazi Gjinore |
| | | 16. Perpilojmë pytësor dhe raporte të monitorimit të kërkuar nga MAPL, ZQM dhe ABGJ, në formë tabelare. | Raportet iu dorëzohen ABGJ,MAPL,ZQM | NJDNJZBGJ |
| | | 17. Raport Vjetor form tabelare I punës së gjat vitit 2025.NR.01-052-2055,dt.14.01.2026 | ZK ABGJ,MAPL,ZQM | NJDNJZBGJ |
| | | 18. Raport Vjetor narativ i punës gjat vitit 2025.NR.01-052/01-2357,dt.15.01.2026 | Raportet iu dorëzohen ZKABGJ,MAPL,ZQM | NJDNJZBGJ |
| | | 19. Raport i funksionimit të Njësitit për vitin 2025, NR.01-400/01-6005,dt.12.02.2026 | Raportet iu dorëzohen ZKABGJ,MAPL,ZQM | NJDNJZBGJ |
| | | 20. Kërkesë APRK në Prishtinë për lidhjen e Momerandum bashkpunimit për angazhimin e Praktikantve me pagesë. | Kërkesa iu dorëzohen APRK në Prishtinë,Nr.01-400/01-6183,dt.16.02/2026 | NJDNJZBGJ |
| | | 21. Raport i monitorimit të zbatimit të Planit të Veprimit për vitin 2025, Nr. 01-052/01-8484. | Raporti me 04.03.2026, i është dorzuar, ZQM | NJDNJZBGJ |
| | | 22. Kërkesë për 8 Mars Nr. 01-070/01-8629,dt.05-03-2026. | Kërkesa i është dorëzuar ZK, DAP,DKRS. | NJDNJZBGJ |
| | | 23. Vendimi i ekipit për të drejtat e fëmijëve me plotësim ndryshim Nr. 01-400/01-8946,dt.09-03-2026. | Vendimi ju dorëzohet të gjithë anëtarëve të EDF. | NJDNJZBGJ |
| | | 24. Raport I aktiviteteve për 8 Mars. Nr. 01-052/01-9051,dt.09-03-2026. | Raportet iu dorëzohen ZK,ABGJ,MAPL,ZQM | NJDNJZBGJ |
| | | 25. Raport për zbatimin e UA Nr.33/2007, për kushte teknike të objekteve ndërtimore, qasjen e PAK, Nr.01-052/01-10106. | Raport, me,18..03.2026 derguar, MMPHI, ABGJ,dhe MAPL, ZQM. | NJDNJZBGJ |

| Nr. rendor | Objektiva | Aktiviteti | Afati | Bartës i aktivitetit |
|---|---|---|---|---|
| | | 26. Raport për shenimin e Ditës Nderkombetare të personave me Sindrom Down. Nr.01-052/01-10453, dt 23-03.2026. | Raportet iu dorëzohen ZK,ABGJ,MAPL,ZQM | NJDNJZBGJ |
| | | 27. Marrëveshje bashkëpunimi me APRK, për punësim të praktikantëve me pagesë. Nr.01-101/01-11408. | Dorëzuar ZK, APRK, Me 31.03.2026. | NJDNJZBGJ |
| | | 28. Raport për shënimin e 2-Prillit ditës Botërore të Ndërgjegjësimit për Autizem.Nr.01-052/01-12266.<br>Dt 03-04.2026. | Raportet iu dorëzohen ZK,ABGJ,MAPL,ZQM | NJDNJZBGJ dhe Handikos |
| | | 29. Raport i takimit të mbijetuarve të dhunës seksuale gjatë luftës, Nr.01-070/01-13611. | Raportet iu dorëzohen ZK,ABGJ,MAPL,ZQM | NJDNJZBGJ dhe ABGJ,QPDG. |
| | | 30. Raport I mbajtjes së ligjëratës vedijesuese në IAAP, "Fehmi Lladrovci" Nr.01-052/01-15067. Dt. 27-04-2026. | Raportet iu dorëzohen ZK,ABGJ,MAPL,ZQM | NJDNJZBGJ,DKA<br>Dhe njësiti I policisë Drenas. |
| | | 31. Raport I mbajtjes së ligjëratës vedisuese në Gjimnaz, "Gjergj Kastrioti Skenderbeu" Nr.01-052/01-15068. Dt. 27-04-2026. | Raportet iu dorëzohen ZK,ABGJ,MAPL,ZQM | NJDNJZBGJ,DKA dhe njësiti I policisë Drenas. |
| | | 32. Raport I takimit me Avokatin e Popullit,Nr.01-052/01-16823 | Takimi u mbajt në ZAP në Prishtinë | NJDNJZBGJ,DKA |
| -II- | **Promovimi i të drejtave të njeriut në komunitet** | 1. Raport I takimit me Policin inspektimi I dhomës mike Nr.01-052/01-16776,dt. 08.05.2026. | Raportet iu dorëzohen ZK,ABGJ,MAPL,ZQM | NJDNJZBGJ, DSHMS |
| | | 2. Raport i mbajtjes së ligjëratës vetdijesuese në SHFMU "Parandalimi dhe pasojat e lëndve narkotike". Nr.01-052/01-17585. dt. 15-05-2026. | Raportet iu dorëzohen ZK,ABGJ,MAPL,ZQM | NJDNJZBGJ dhe DKA, PKD |
| | | 3. Rekomandim për organizimin e programit për 1 Qershorin, për të gjitha SHFMU të komunes së Drenasit, Nr.01-052/01-17801. dt. 18-05-2026. | Rekomandimi iu dorëzua të gjitha SHFMU ZK,ABGJ,MAPL,ZQM | NJDNJZBGJ.DKA, PKD. |

| Nr. rendor | Objektiva | Aktiviteti | Afati | Bartës i aktivitetit |
|---|---|---|---|---|
| | **Promovimi i të drejtave të njeriut në komunitet** | 4. Raport i mbajtjes së ligjëratës vedisuese në IAAP, "Fehmi Lladrovci" tema Festo me zemër jo me armë. Nr.01-052/01-17973. dt. 19-05-2026. | ZK,ABGJ,MAPL,ZQM | NJDNJZBGJ.DKA, MPM,PKD. |
| | | 5.Raport për 31Majin DNPD, Nr.01-052/01-20015. dt. 01-06-2026. | Raportet iu dorëzohen ZK, ABGJ, MAPL, ZQM | NJDNJZBGJ dhe DKA, DSHMS, PKD |
| | | 6. Raport me rastin e 1-Qershorit, ditës Nderkombetare për të drejtat e fëmijëve Nr.01-052/01-20013. dt. 01-06-2026. | Raportet iu dorëzohen ZK,ABGJ,MAPL,ZQM | NJDNJZBGJ dhe DKA, PKD |
| | | 7. Njoftim për të gjitha shkollat rreth 12-Qershorit-Ditës Ndërkombëtare për parandalimin e punëve të rënda, Nr.01-070/01-21740. dt. 09-06-2026. | Raportet iu dorëzohen ZK,ABGJ,MAPL,ZQM, SHFMU | NJDNJZBGJ dhe DKA, PKD |
| | | 8.Raport 12-Qershorit-Ditës Ndërkombëtare për parandalimin e punëve të rënda dhe mbajtja e dy ligjeratave në SHFMU "Rasim Kiqina", Nr.01-052/01-23408. dt. 18-06-2026. | Raportet iu dorëzohen ZK,ABGJ,MAPL,ZQM, SHFMU | NJDNJZBGJ dhe DKA, PKD |
| | | 8. Raport 12-Qershorit-Ditës Ndërkombëtare për parandalimin e puneve të rënda dhe mbajtja e dy ligjëratave në SHFMU "Ali Gashi", Nr.01-052/01-23411. dt. 18-06-2026. | Raportet iu dorëzohen ZK,ABGJ,MAPL,ZQM, SHFMU | NJDNJZBGJ dhe DKA, PKD |

## Zyra Ligjore

Në kuadër të obligimeve ligjore dhe përshkrimit të punëve që ka Zyra Ligjore e Drenasit, më poshtë e gjeni Raportin e Punës e zyrës ligjore të Komunës së Drenasit për periudhen Janar-Qershor 2026 i Zyrës Ligjore.

Departamenti ligjor në kuadër të Zyrës së Kryetarit në Komunën e Drenasit në vazhdimësi punon drejt krijimit të një sistemi ligjor i cili garanton hartimin e akteve juridike sipas legjislacionit në fuqi, hartimin dhe procesimin e shkresave juridike për lëndët gjyqësore në të cilat Komuna Drenas/Gllogoc është palë në procedurë si me vetë iniciativë ashtu edhe sipas obligimit të dhënë nga gjykata, përmbajtje dhe formë të aktit normative sa më të saktë si nga aspekti përmbajtësor ashtu edhe nga aspekti teknik,mendime juridike, profesionale dhe rekomandime tjera në përmbushjen e ligjshmërisë sa i përket organeve komunale si dhe përshtatje të procedurave, teknikave dhe mjeteve materiale me nevojat e fushë veprimatrisë përkatëse.
Raporti është paraqitur me objektiva, aktivitete, bartës të aktiviteteve, me afate kohore.

| Nr. ren dor | Objektiva | Aktiviteti | Afati | Bartës i aktivitetit |
|---|---|---|---|---|
| -I- | **Pranimi, shqyrtimi, dhe proceduar tutje në organet administrative, gjygjësore apo edhe brenda vet institucionit, këto lëndë:** | - 58 Përgjigje në Padi | Kanë përfunduar brenda afatit ligjor | **ZK** |
| | | - 32 Ankesa të parashtruara për në Gjykatën e Apelit | Kanë përfunduar brenda afatit ligjor. | **ZK** |
| | | - 10 Fjalë përfundimtare | Kanë përfunduar brenda afatit ligjor. | |
| | | - 5 Përgjigje në Kërkesë | Kanë përfunduar brenda afatit ligjor. | **ZK** |
| | | - 52 Hartime të akteve ( vendime,aneks kontrata etj.) | Kanë përfunduar brenda afatit ligjor. | **ZK** |
| | | - 02 Padi | Kanë përfunduar brenda afati ligjor | **ZK** |
| | | - 435 Propozime përmbarimore | Kanë përfunduar brenda afatit ligjor. | **ZK** |
| | | - 09 Prapësime | Kanë përfunduar brenda afatit ligjor | **ZK** |
| | | - 01 Përgjigje për masë të sigurisë | Kanë përfunduar brenda afatit ligjor | **ZK** |
| | | - 06 Deklarime për seancë | Kanë përfunduar brenda afatit ligjor | **ZK** |

| Nr. ren dor | Objektiva | Aktiviteti | Afati | Bartës i aktivitetit |
|---|---|---|---|---|
| -II- | **Përfaqësimi i Komunës së Drenasit pranë të gjithë gjykatave në Republikën e Kosovës.** | - 98 Seanca gjyqësore | Janë mbajtur në bazë të datës së planifikuar nga ana e Gjykatës. | **ZK** |
| | | - 46 Parashtresa të cilat përfshijnë: përmbushjen e obligimeve të gjykatave të dhëna sipas aktvendimeve në procesverbalet e shqyrtimeve gjyqësore dhe të tjera. | Janë dorëzuar në gjykatë brenda afatit të caktuar për mbajtjen e seancës. | **ZK** |
| **-III-** | **Të Tjera** | Në kuadër të departamentit ligjor në kuadër të Zyrës së Kryetarit në Komunën e Drenasit mes tjerash janë kryer edhe hartimi I detyrimeve Kontigjente sipas kërkesës së ZKF-së dhe brenda afateve të parapara me ligj, realizimi i detyrave në përputhje me politikat e institucionit, me standardet administrative dhe procedurat teknike dhe duke marr parasysh praktikat profesionale si dhe janë dhënë këshilla dhe opinione ligjore në të gjitha rastet që është kërkuar nga ana e Drejtorive përkatëse. | Kanë përfunduar brenda afatit ligjor | **ZK** |

## Zyra për Integrime Evropiane

| Nr. rendor | Objektiva | Aktiviteti | Afati | Bartës i aktivitetit | |
|---|---|---|---|---|---|
| 1. | Përmbushja e obligimeve Komunale nga Agjenda Evropiane Programi Kombëtar për zbatimin e MSA-së 2022-2026. Raporti i Komisionit Evropian për vendin (Kosovën) | 1.1. Raporti vjetor i Kryetarit për vitin 2024, Hartimi i Planit gjithëpërfshirës dhe individual për përmbushjen e obligimeve nga Agjenda Evropiane Identifikimi i obligimeve të Komunës nga PKZMSA;<br>1.2. Identifikimi i obligimeve të komunave nga Raporti i vendit ;<br>1.3. Raporti për zbatimin e obligimeve të komunave që dalin nga Agjenda Evropiane.<br>1.4. Matrica gjithëpërfshirëse dhe individuale e raportimit në Komuna; | 1.1. Janar 2025 I Përmbushur Janar- Qershor 2026 Përmbushur<br>1.2. Përmbushur<br>1.3.I kryer në afatin kohor<br>1.4.E përmbushur | ZKIE Kryetari MAPL.<br>ZKIE-MAPL | |
| 2 | Harmonizimi i aktiviteteve me aktet ligjore të Qeverisë në Koordinimin e procesit të zhvillimit të kornizës rregullative dhe të politikave të Komunës që ndërlidhen me procesin e integrimit evropian dhe që dalin nga dokumente strategjike, si ato nacionale ashtu edhe ato lokale, të këtij procesi, përfshirë pjesëmarrjen në caktimin e prioriteteve komunale në këtë aspekt dhe koordinimin e realizimit të obligimeve të Komunës që dalin nga marrëdhëniet Kosovë-BE; | 2.1. Koordinimi i procesit të integrimit evropian.<br>2.2. Koordinimin e aktiviteteve me Kryetarin e Komunës dhe Drejtorët e Drejtorive në Komunë në implementimin e obligimeve që rrjedhin nga PKZMSA-ja dhe aktivitete tjera në funksion të procesit të integrimeve evropiane<br>2.3 Koordinimin me organizatat qeveritare dhe jo qeveritare të cilat ofrojnë asistencë - përkrahje në implementimin e PKZMSA -së dhe merr pjesë në këto grupe punuese. | 2.1. Janar-Dhjetor 2026. I vazhdueshëm<br>2.2.Janë përcjellë të gjitha aktivitetet që dalin me dokumente të reja, miratuar plani i veprimit për transparencë si dhe Planin Lokal për Strategji të Cilësisë së Ajrit-Komuna e Drenasit 2025-2029. Plani Komunal për integritet i përditësuar me masat e veprimit për vitin 2026 këto dokumente janë miratuar sipas procedurave ligjore në fuqi. | ZKIE Zyret e Kryetarit. Drejtorit. ZKP | |

| **Nr. rendor** | **Objektiva** | **Aktiviteti** | **Afati** | **Bartës i aktivitetit** | |
|---|---|---|---|---|---|
| | Planin dhe programin e punës që rrjedhin nga implementimi i Planit të Veprimit i Marrëveshjes për Stabilizim-Asociimit (PVMSA) ,në pajtim me Ligjet, Rregulloret dhe aktet tjera të organeve të pushtetit qendror dhe lokal | | | | |
| 3 | Monitorimi i zbatimit dhe raportimi për obligimet nga agjenda evropiane | 3.1. Raport periodik lidhur me përmbushjen e obligimeve nga agjenda evropiane<br>Janar – Qershor<br>Korrik – Dhjetor<br>3.2. Raportimi vjetor në MAPL lidhur me përmbushjen e obligimeve të cilat dalin nga agjenda evropiane. | 3.1Janar-Qershor 2026<br>I përmbushur<br>Korrik-Dhjetor 2026<br>I vazhdueshëm | ZKIE në bashkëpunim me drejtori dhe zyre komunale.<br>MAPL. | |

| Nr. rendor | Objektiva | Aktiviteti | Afati | Bartës i aktivitetit | |
|---|---|---|---|---|---|
| 4 | Forcimi i koordinimit ndërinstitucional në procesin e Integrimit Evropian. Takime lidhur me përmbushjen e obligimeve nga agjenda evropiane | 4.1. Marrja pjesë në takimet të bordit të drejtorëve në fushën e IE.<br><br>4.2. Takime të rregullta me drejtorët e drejtorive si dhe shefat e sektorëve përkatëse sa i përket përmbushjes së obligimeve të cilat dalin nga PKZMSA-së -ja.<br>4.3. Marrja pjesë në mbledhjet për planifikim buxhetor.<br>4.4. Marrja pjesë në takime dhe trajnime në MAPL, MIE dhe Ministri e institucione të tjera që kanë të bëjnë me integrime evropiane.<br>4.5. Marrja pjesë në Kolegjiumin e ZKIE të Asociacionit të Komunave të Kosovës me Zyrtarët tjerë komunalë për Integrime Evropiane. | 4.1. Njoftim dhe pjesëmarrje në takime në Fushën e Integrimeve Evropiane.<br>4.2. I Vazhdueshëm<br><br>4.3. Përcjellja dhe marrje pjesë në planifikimet dhe dëgjimet buxhetore.<br>4.4. Pjesëmarrje në takime që i ka organizuar MAPL-OSBE e Ministri tjera lidhur me procesin e IE.<br>4.5. Pjesëmarrje në hartimin e planit të punës të kolegjiumit për integrime evropiane, si dhe sfidat që kanë dalë nga raporti i MAPL-së dhe i vendin për Kosovën | ZKIE<br><br>ZKP, drejtoria për buxhet dhe Financa, të gjitha Drejtorit dhe Zyrat.<br>ZKIE.<br><br>ZKIE<br>MAPL | |

| Nr. rendor | Objektiva | Aktiviteti | Afati | Bartës i aktivitetit | |
|---|---|---|---|---|---|
| 5 | Adresimi i sfidave të komunave që dalin nga Raporti i komisionit Evropian për vendin (Kosovën) Raportimi Kryetarit dhe MAPL-së, nga Përmbushja e Obligimeve Komunale nga Agjenda Evropiane në baza periodike dhe sa herë që kërkohet. | 5.1. Organizim dhe bashkëpunim me Kryetarin e Komunës dhe Drejtorët e drejtorive e shefa të sektorëve për realizimin e obligimeve të komunave të cilat dalin nga agjenda evropiane dhe zbatimi i legjislacionit në fuqi lidhur me këto obligimeve.<br>5.2. Raportimi vjetor Kryetarit dhe në MAPL. | 5.1I Vazhdueshëm<br><br>5.2 I vazhdueshëm<br><br>5.2.I përmbushur në afatet kohore | ZKIE Drejtorit Kryetari MAPL. | |

## Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim

*Raporti i punës Janar – Qershor 2026*

| Nr. rendor | Objektiva | Aktiviteti | Afati | Bartës i aktivitetit |
|---|---|---|---|---|
| | 1. Buxheti për vitin 2026-2028 i hartuar dhe i aprovuar (Rregullorja e qeverisë për ZKKK-të 02/2010, neni 10.1) | 33. Në bashkëpunim me Kryetarin e Komunës ZKKK do të avokoj për buxhet të mjaftueshëm për 2026 | I përfunduar | ZKKK, ZK, DBF-ZKF |
| | | 34. Udhëheqësi i zyrës në bashkëpunim me zyrtarin për financa do të hartoj buxhetin për vitin 2026 | I përfunduar | ZKKK |
| -I- | 2.Pjesëmarrja e rregullt në takimet që mbahen në Komunë (Rregullorja e qeverisë për ZKKK-të 02/2010, neni 7.1.7) | **35.** Krijon kalendarin e aktiviteteve të zyrës | I përfunduar Trajnim për Integrimin e të huajve në Republikën e Kosovës | ZKKK |
| | 1.Çështjet specifike dhe nevojat e të gjitha komuniteteve, personave të riatdhesuar janë të adresuara tek institucionet lokale | 36. Merr planin vjetor të takimeve të KK-së dhe mban takime të rregullta me Komitetin për Komunitete si dhe takimet me KKSB<br><br>37. Takimet me anëtaret e Kolegjiumit për Komunitete dhe Kthim, si anëtare e këtij Kolegjiumi | I përfunduar -Kemi mbajtur 2 takime me KK, temë e diskutimeve Plani i punës së KK dhe raportim nga ZKK, 3 takime me KKSB.<br><br>Mbledhja e kolegjiumit - 1 | ZKKK, ZK<br><br>AKK, KZKK |
| | | 38. Raportim i rregullt tek Kryetari, Asambleja Komunale, Komiteti për Komunitete, nëse këkohet tek institucionet qendrore, për implementimin e projekteve për personat e riatdhesuar dhe komunitetet. | Në baza të rregullta 2026 | ZKKK |
| | | 7. Raporti gjashtëmujor | I perfunduar dorëzuar tek ZK, ZKK, MPB | ZKKK |
| -II- | 2.Plani i Komunal i Veprimit për Riintegrimin e personave të Riiatdhesuar dhe integrimin e të huajve | 8.Këshillimi i personave të riatdhesuar | Këshillimi në baza ditore, të riintegruar kemi 10 persona, 6M dhe 4F Verifikimi në teren është bërë i të gjitha rasteve së bashku me MPB. | ZKKK |

| Nr. rendor | Objektiva | Aktiviteti | Afati | Bartës i aktivitetit |
|---|---|---|---|---|
| | 2026-2028<br><br>3.Bashkëpunimi me organizatat vendore dhe ndërkombëtare “GIZ”, “CARITAS”, “INTEGRA” | 4. Referimi i personave të riatdhesuar tek autoritetet relevante komunale bazuar në nevojat dhe profilin e tyre<br>5. Komisioni Komunal për Riintegrim<br><br>6. Regjistrimi civil<br><br>7. Qasje në Punësim, Arsim Shëndetësi, mirëqenie sociale dhe dikaster të tjerë<br><br>8. Ngritja profesionale për vetëpunësim, ngritje profesionale e personave të riatdhesuar(Trajnime duke u paisur me Diploma) dhe me mjete pune<br><br>9. Ndihmë personave të riatdhesuar me cenueshmëri<br><br>10. Këshilli Komunal Kordinues në Mbrojtje të Viktimave të Dhunës në Baza Gjinore<br><br>11. Pjesëmarrja e organizatave vendore dhe ndërkombëtare, në takime punëtori aktivitete të tjera.<br><br>12. Plani Komunal për riintegrimin e personave të riatdhesuar dhe integrimin e të huajve<br>2026-2028 | Në baza të rregullta<br>Kemi mbajtur 1 takim të KKR,<br><br>-Janë pajisur me dokumente të gjendjes civile<br>-Në zyën e punësimit janë paraqitur dhe kanë marrur informatat e nevojshme të gjithë personat e riatdhesuar.<br>-1familje (4 anëtarëshe) dhe një person kemi me Asistencë sociale.<br>1 familje vazhdim akomodimi, gjëra ushqimore dhe higjenike, këshilla psikologjike.<br><br>1 mbledhje<br><br>Org. “GIZ”-1 raste të referimit.<br><br>-Formimi i grupit për planin e punës, plani është miratuar në Kuvend dhe ka marr ligjshmërinë nga MAPL dhe MPB. | ZKKK, ZP, QPS<br><br>ZKKK, ZK, KK, MAPL |

## Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore

Për gjashtë mujorin e parë të vitit 2026, Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore ka azhuruar listat e pagave sipas ndryshimeve, konform zhvillimeve në stafin e punëtorëve.

Paraqita në formë tabelare e realizimit sipas azhurimit në listë të pagave:

| Muaji - viti | Punëtor i ri | Ndryshim e | Punëtor të larguar | Pagesa retroakt iv | Lista e kuvendit, zjarrfiksave, etj. |
|---|---|---|---|---|---|
| Janar 2026 | 18 | 2 | 21 | 71 | Lista për anët.dhe anët. të KK |
| Shkurt 2026 | 8 | 5 | 3 | / | Lista për anët.dhe anët. të KK |
| Mars 2026 | / | 6 | 2 | 28 | Lista për anët.dhe anët. të KK |
| Prill 2026 | / | 3 | / | 45 | Lista për anët.dhe anët. të KK |
| Maj 2026 | 3 | 5 | 12 | 7 | Lista për anët.dhe anët. të KK |
| Qershor 2026 | / | 7 | / | 11 | Lista për anët.dhe anët. të KK |

Për kërkesat e njësive kërkuese për plotësim të pozitave të lira të punës nga muaj Shkurt 2026 është filluar me konkurse të jashtme.
Pas këtij hapi si dhe interesimi i njësive kërkuese që sa më parë të zhvillohen procedurat rekrutuese për pozitat e lira të punës, kërkesat për plotësimin e pozitave me rastin e pensionimit, me ndërprerje të marrëdhënies së punës për arsye të ndryshme, si dhe pozitat e lira të punës të planifikuara me PPI për vitin 2026 pas Plotësim – ndryshimeve ligjore dhe akteve nënligjore në nivel vendi, është filluar për vitin 2026 me shpallje të konkurseve – pranim (konkurse të hapura-publike në gjashtë mujorin e parë të vitit 2026 janë shpallur pesëmbëdhjetë (44) grup pozitash: pas përfundimit me sukses të procedurave rekrutuese me përzgjedhje, prej tyre janë plotësuar me sukses 21 raste, 1 raste ka dështuar si dhe pas përfundimit të procedurave rekrutuese është në fazën e ankimimit dhe një (1) rast.
Plotësimi i pozitave të lira të punës në shërbimin civil në Komunën e Drenasit nuk ka filluar në gjashtë mujorin e parë janar-qershor 2026, për shkak të nxjerrjes së rregullores nr. 07/2025 për procedurën e pranimit në shërbimin civil, nga niveli qendror, e cila rregullore bie ndesh me ndarjen e pushteteve dhe është në kundërshtim me Kushtetutën e Kosovës, ku për këtë arsye edhe kjo rregullore ka shkuar për vlerësim të kushtutështhmërisë pranë Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nga ana e Asosacioni i Menaxherëve të Personelit dhe Asocacioni i Komunave të Kosovës, prandaj jemi në pritje të një vendimi Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës për këtë çështje, që pastaj të vazhdojmë me procedurat e rekrutimit të vendeve të lira në shërbimin civil në Komunë të Drenasit.

**Nga KPMSHCK:** Dosjet personale për disa shërbyes civil, Akt emërime, Lista e Pagave për muaj të caktuar, Kualifikimi (diplomë ose certifikatë), lista e shërbyesve civil në pushim të lehonisë 2026, punë shtesë të shërbyesve civil, procedurën e pensionimit me arritjen e moshës, raporti periodik i evidences së hyrjeve dhe daljeve të punëtorëve për periudhë të ndryshme mujore, procedura rekrutuese të konkurseve të mbyllura (të brendshme).

Transferimet brenda kategorisë dhe procedura rekrutuese të konkurseve – pranim (konkurse publike), si dhe lidhur me punët dhe detyrat e tjera që dalin nga kompetencat e Njësisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore.

Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore është përgjigjur dhe ka plotësuar dokumentacionin në bazë të detyrës zyrtare edhe sipas kërkesës së Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës lidhur me rastet ankimore.

Po ashtu, Njësisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore dhe njësia e personelit sipas detyrës Zyrtare dhe sipas Rreg.nr.01/2024 ka rolin e sekretarisë për përgatitjen e seancave sipas ankesave, për Komisionin Disiplinor, ku janë zhvilluar seancat: Ankesat kanë qenë; ankesa për masë disiplinore.

Njësisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, gjithë ashtu ka përgatitur kontratat, akt emërimet, vendimet për pushime pa pagesë, pushimet e lehonisë, pensionimet, vendimet për lirim/dorëheqje nga vendi i punës në Komunën e Drenasit, si dhe ju është përgjigjur në të gjitha ankesat dhe kërkesat e ndryshme nga gjykata, hetusia, avokatët si dhe palët tjera të interesuara.

## Drejtoria për Administratë të Përgjithshme

Raporti në vijim paraqet punën e sektorëve të Drejtorisë për Administratë të Përgjithshme gjatë periudhës Janar- Dhjetor 2026 duke u bazuar në plan e punës.

I. Sektori i Gjendjes Civile

Sektori i Gjendjes Civile ka përmbushur objektivat e planit të punës duke ofruar shërbime për qytetarët me efikasitet, pa pritje në sportele. Sipas statistikave të nxjerra nga sistemi i GJC-së, në afatin e paraparë ligjor dokumente për përdorim të brendshëm janë lëshuar **13,936**, dokumente për përdorim të jashtëm **8,674,** që në total janë **22,610**. Ndërsa, gjatë vitit 2026 kemi ofruar shërbime elektronike edhe përmes E-kioskës në Komoran dhe në Drenas. Nga E-kioska në Komoran janë lëshuar 9 dokumente, ndërsa në Drenas janë lëshuar 63 dokumente.

Nga sistemi i Gjendjes Civile, nga data 01.01.2026 deri me 30.06.2026 për përdorim të brendshëm janë lëshuar këto dokumente:

1. Ekstrakte të lindjes- 8458
2. Certifikata të lindjes- 565
3. Certifikata të martesës 1456
4. Certifikata të vdekjes 659
5. Certifikata të vendbanimit- 252
6. Certifikata të shtetësisë 11
7. Certifika të Gjendjes martesore 456
8. Certifikata të Bashkësisë Familjare 1990
9. Vërtetim nga arkiva 89

TOTALI- 13936

Ndërsa, dokumente të lëshuara për përdorim të jashtëm nga sistemi i Gjendjes Civile janë si në vijim:

1. Ekstrakte të lindjes - **1107**
2. Certifikata të lindjes - **4551**
3. Certifikata të martesës - **1379**
4. Certifikata të vdekjes - **117**
5. Certifikata të vendbanimit – **703**
6. Certifikata të shtetësisë - **24**
7. Certifikata të statusit martesor -**182**
8. Certifikata të bashkësisë familjare -**499**
9. Vërtetime nga arkiva -**112**

Totali- 8684

-Aktvendime për ndërrime të emrit dhe mbiemrit, regjistrime të mëvonshme të lindjes, vdekjes**,** gjithsej **-99**
-Kërkesa për humbje të shtetësisë së Kosovës- **4**
**-**Kërkesa për fitim të shtetësisë së Kosovës – **53**
**-**Regjistro lindje- **110**

-Rishkrim lindje-**28**
-Martesa të lidhura-**207**
-Rishkrim martese-**68**
-Verifikime në sistem -**63**
-Vdekje-**103**
-Regjistro vdekje-**43**
-Shkurorëzime-**10**

## II. Qendra për Shërbim të Qytetarëve

Në Qendrën për Shërbim të Qytetarëve janë regjistruar 10,227 lëndë. Në këtë sektor të gjitha kërkesat e qytetarëve janë adresuar me kohë nëpër drejtoritë dhe zyrat komunale, duke treguar efikasitet, profesionalizëm dhe përkushtimin ndaj qytetarit. Siç shihet nga tabela me poshtë, në muajin Qershor ka pasur më së shumti regjistrim të lëndëve me 2,617.

| Nr. rendor | Objektiva | Aktiviteti | Afati | Bartës i aktivitetit |
|---|---|---|---|---|
| **-I-** | **Shërbime efikase ndaj qytetarëve (10, 227 lëndë)** | 1. Janë pranuar dhe regjistruar 1,566 lëndë të ndryshme, të klasifikuara sipas shenjave klasifikuese | Janar 2026 | QSHQ |
| | | 2. Janë pranuar dhe regjistruar 1,288 lëndë të ndryshme, të klasifikuara sipas shenjave klasifikuese | Shkurt 2026 | QSHQ |
| | | 3. Janë pranuar dhe regjistruar 1,394 lëndë të ndryshme, të klasifikuara sipas shenjave klasifikuese | Mars 2026 | QSHQ |
| | | 4. Janë pranuar dhe regjistruar 1,711 lëndë të ndryshme, të klasifikuara sipas shenjave klasifikuese | Prill 2026 | QSHQ |
| | | 5. Janë pranuar dhe regjistruar 1,651 lëndë të ndryshme, të klasifikuara sipas shenjave klasifikuese | Maj 2026 | QSHQ |
| | | 6. Janë pranuar dhe regjistruar 2,617 lëndë të ndryshme, të klasifikuara sipas shenjave klasifikuese | Qershor 2026 | QSHQ |
| **-II-** | **Rritja e shërbimeve efikase dhe punët shtesë në menaxhim** | Qendra për shërbimin e qytetarëve në komunë bashkëpunon me drejtorit komunale dhe njësit organizative brenda drejtorive komunale.<br>Qendra pranon dhe procedon për shqyrtim dhe vendosje kërkesat e qytetarëve në drejtorit komunale dhe njësit organizative brenda drejtorive.<br>Po ashtu punë tjera si:<br>- Bashkangjitja dhe miratimi i lëndëve në sistemin e intranetit.<br>- Menaxhimi i kontratave në cilësinë e menaxheres | Janar-Qershor 2026 | QSHQ |

| Nr. rendor | Objektiva | Aktiviteti | Afati | Bartës i aktivitetit |
|---|---|---|---|---|
| | | (obligim me vendim të veçantë).<br>- Gjatë këtij gjashtëmujori është punuar edhe në Komisione të ndryshme për hapje dhe vlerësim të ofertave të prokurimit si dhe komisione për subvencione nga Reload dhe komision monitorues. Po ashtu në komision për hartimin e rregullores dhe përpilimin e listës së Shenjave Unike të Klasifikimit të dokumenteve dhe afatet e ruajtjes së tyre në Komunën e Drenasit. | | |

## III. Zyra e Prokurimit

Gjatë periudhës 01.01.2026 deri më 30.06.2026 në Zyrën e Prokurimit Publik janë bërë kërkesa nga të cilat:

1. Zyra e prokurimit

a. Nga këto kërkesa kjo Zyrë ka zhvilluar **33 procedura**, prej tyre për:

1. Vlera minimale 3
2. Kuotime të çmimeve 10
3. Punë shtesë 2
4. Procedura të hapura 17
5. Procedure me Negociata 2
6. Minitender 1

b. Janë nënshkruar **24 kontrata**, prej tyre për:

1. Vlera minimale 5
2. Kuotime të çmimeve 6
3. Vlerë e mesme 5
4. Vlerë e madhe 3
5. Procedurë me Negociata 2
6. Minitender 1

d) Anulime (2)

| Pranimi dhe shqyrtimi i kërkesave | ▪ Gjatë periudhes gjashtë mujore në adresë të DSHPE-së janë pranuar kërkesa dhe lëndë të natyrave të ndryshme gjithësej:<br>- 253 – kërkesa dhe lëndë të ndryshme (prej tyre 168 të miratuara, 6 të refuzuara, 1 të anuluar, 2 të hedhura poshtë , 1 ceduar dhe 72 në proces) siç janë:<br>- kërkesa për mirëmbajtje të kanalizimit dhe gropave septike, të cilat janë realizuar dhe trajuar të gjitha,<br>- kërkesa për shenjëzim horizontal dhe vertkal të komunikacionit,<br>- kërkesa për zhavor për rrugët e rendit të IV,<br>- kërkesa për renovimin e gropave të asfaltit,<br>- kërkesa për zgjerim të ndriçimit publik,<br>- kërkesa për pastrimin e deponive ilegale të mbeturinave,<br>- kërkesa për rregullimin e rrethojave për varreza,<br>• Janë bërë përgatitjet e kërkesave për pagesën e faturave për shërbimet komunale (Ndriçim Publik, ujë, Mbeturina, Energji elektrike), dhe janë proceduar për pagesë, dhe duhet përmenduar fakti së mjetet buxhetore nga Shpenzimet komunale për muajin Mars-Prill janë marrë nga Thesari, andaj kemi mungesë të mjeteve buxhetore, andaj duhet të bëhet planifikim për bartje gjatë rishikimit të buxhetit për muajin Qershor ose Korrik, në mënyrë që të këmi pagesa të rregullta, dhe të mos ndërpritet nga KEDS-i, furnizimi me energji për insitucionet publike dhe ndriçim Publik. |
| Njësia profesionale e Zjarrfikësve dhe Shpetimit | DSHPE-ja në bashkëpunim të plotë me Njësinë Profesionale të Zjarrfikësve dhe Shpëtimit (NJPZSH ), gjatë gjashtë mujorit të pare në teritorin e komunës së Drenasit, ka pasur situata emergjente si: Intervenimet gjatë vershimeve të muajit janar dhe Intervenimet në shuarje të zjarreve fushore dhe malore të cilat shumica prej tyre, dyshohet që janë shkaktuar si pasojë e pakujdesisë nga faktori njeri, po ashtu zjarret në objektet e banimit dhe objektet tjera. Për të gjitha rastet janë marrë masat për reagim të shpejt në parandalimin dhe zvoglimin e dëmeve. Pjesëmarrja ka qenë aktive në: 138 rastet emërgjente duke përfshirë të gjitha rastet e FNFT.<br>Intervenimet e NjPZSH-së ishin si në vijim:<br>1) Shuarje të zjarreve …………………………………………… 77<br>2) Vërshime ……………………………………………............… 28<br>3) Shërbime të tjera …………………………………………..…… 14<br>4) Intervenime teknike ……………………………………....… 16 |

| | Arritjet/progresi/përformanca kyçe gjatë gjashmujorti të parë të vitit 2026 |
|---|---|
| | 5) Intervenime në aksidente rrugore ……………………………..…. 3 |
| Takimet zyrtare | • Takim me organet kompetente që mundë të kontribojnë, me qëllim të bashkëpunimit në mbarëvajtjen e punëve në Drejtorinë e Shërbimeve Publike<br>• Takime me përfaqësuesit e organizatës së GIZ-it dhe AMMK-së (takime fizike dhe online, për çështje të Grandit për përformancë të Mjedisit të pastërt dhe procesin e raportimit vjetor për menaxhimin e mbeturinave),<br>• Takim me Asociacionin e Komunave të Kosovës,<br>• Takim me Agjencinë e Menaxhimit të Emërgjencave-AME,<br>• Takim me strukturat e KEDS-it,<br>• Takime me administratorët e fshatrave, me biznese, me qytetarë rreth menaxhimit të mbeturinave, ndarjes dhe zgjerimit të shërbimit, furnizim me ujë pijshëm. |

## Drejtoria për Zhvillim Ekonomik

| Nr. | Objektivat | Aktivitetët | Afati | Bartës të akt. |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Raporti i punës 2025 për Drejtorinë e Zhvillimit Ekonomik | 1.1.Mbledhja e të dhënave<br>1.2.Përgatitja e të dhënave lidhur me Raportin<br>1.3. Përpunimi final i Raportit | Janar | Udhëheqësi dhe drejtori |
| 2 | Implementimi i Strategjisë së Zhvillimit Ekonomik Lokal 2025-2029 | 2.1. Realizimi i planit të veprimit për vitin 2025<br>2.2.Vlerësimi dhe raportimi i planit të veprimit për vitin 2025 nga komisioni komunal.<br>2.3.Dërgimi i raportit tek komisioni i performancës. | Janar - Mars | DZHE dhe komisioni |
| 3 | Funksionalizimi i Zonës Ekonomike, vizitat e bizneseve dhe përkrahja me subvencioneve. | 3.1. Bashkpunimi me MNT lidhur me zhvillimet e punimeve në Zonën Ekonomike<br>3.2. Vizita në bizneset e ndryshme.<br>3.3**.** Takim me GIZ-in lidhur me mundësin e bashkëpunimit.<br>3.4.Analiza sektoriale | Janar - Qershor | Drejtori, Udhëheqësi, Komisioni. |
| 4. | Regjistrimi i bizneseve, ndryshimeve, shuarjeve, duplikat | 4.1Aplikimi/ Procedimi i lëndëve në ARBK.<br>4.2.Regjistrimi pas miratimit nga ARBK.<br>4.3Regjistrimi i bizneseve fillestare - gjatë periudhes Janar – Qershor 2025 janë regjistruar 140 biznese prej tyre SHPK -100 ndërsa 40 BI.<br>4.4.Nxjerrë Çertifikatën e biznesit me ,nr. Unifikues dhe informata shtesë – ripërtërirë - 35.<br>4.5.Kërkesë për informata shtesë -94.<br>4.6.Kërkesë për shtimin apo heqjen e aktivitetit -94.<br>4.7.Kërkesë për ndryshim të adresës – 16.<br>4.8.Kërkesë për shtim apo ndryshim të njësisë - 14.<br>4.9.Kërkesë për certifikatë dublikat -9.<br>4.10.Kërkesë për ndryshim të emrit tregtar -6.<br>4.11. Kërkesë për ndryshimin e pronarëve/ aksionarëve -14.<br>4.12. Kërkesë për ndryshimin e drejtorit apo përfaqësuesit të autorizuar -19.<br>4.13. Kërkesë për ndryshim të emrit – 10.<br>4.14. Kërkesë për ndryshim të emalit ose adresës – 6.<br>4.15. Kërkesë për shuarje të biznesit -13.<br>4.16.Kërkesë për shuarje të njësisë - 1.<br>4.17. Kërkesë për ndryshim të numrit të punëtorëve -1.<br>4.18.Gjithsej shërbime të kryera në zyren e regjistrimit të biznesëve janë 433. | Janar - Qershor | Zyrtaret përkatës dhe Udhëheqësi |

| Nr. | Objektivat | Aktivitetët | Afati | Bartës të akt. |
|---|---|---|---|---|
| 5 | Ngarkesa e bizneseve me taksë vjetore sipas rregullores në fuqi dhe inkasimi. | 5.1.Azhurnimi i taksës komunale.<br>5.2.Regjistrimi i bizneseve fillestare në programin E-Taksa.224<br>5.3.Verifikimi/Faturimi i bizneseve pasive sipas listës së ARBK-së1550 biznese.<br>5.4.Verifikimi i bizneseve të shuara sipas listës së ARBK-së 1011 biznese.<br>5.5.Deklarimet "zero" gjatë periudhës Janar – Qershor 2026- janë 10 kërkesa në vlerë prej 2050.00 €.<br>5.6.Inkasimi i taksës komunal gjat periudhes Janar – Qershor 2026 janë 21 pagesa në vlerë prej 15,320.00€.<br>5.7.Futja e pagesave në sistemin E-Taksa<br>5.8.Barazimi me DF për pagesat mujore.<br>5.9.Miratimi i lëndëve në intranet -47 | Janar - Dhjetor | Zyrtaret përkatës dhe Udhëheqësi |
| 6 | Identifikimi i zonave turistike dhe bashkëpunimi me ministrit e linjës. | 6.1Promovimi i turizmi në aspektin ekonomik lokal.<br>6.2.Pjesmarrja në "Panairn Nderkombetar të Turizmit 2026"(dy ditor)<br>6.3. Hartimi i broshurës me potencialet të zonave turistike të Komunës së Drenasit;<br>6.4. Pjesmarrja në Panairin" Promovimi i drejtpërdrejtë i komunës si destinacion turistik dhe agroturistik, organizuar nga CEO shpk - Congress and Event Organization në Prishtinë, pjesëmarrja e disa bizneseve të perzgjrdhura për promovimin e komunës përmes produkteve të tyre.<br>6.5.Identifikimi i atraksioneve turistike<br>6.6.Promovimi i turizmit historik<br>6.7. Bashkëpunimi me Ministrit e linjës – Tërheqja e turistëve në destinacionet turistike të komunës. | Vazhdue-shme | Zyrtari përkatës, Udhëheqësi Drejtori dhe Komisioni komunal |
| 7 | Bashkëpunimet me ministritë e linjës, donatorët dhe ambasadat, lidhja e memorandumeve me akterët e ndryshëm, OJQ-të, hartimi i orarit të barnatoreve. | 7.1.Zhvillimi i dokumenteve dhe materialeve me qëllim të tërheqjes së investitorëve të jashtëm dhe vendor.<br>7.2.Bashkpunimi sipas marrveshjes së mirëkuptimi në mes të Komunës së Drenasit dhe organizatës së bashkëpunimit me organiziaten Kosova-Women 4 Women;<br>7.3. Publilkimi i thirrjes për përkrahjen financiare të NMVM-ve në skemën e granteve për energji të pastër nga KIESA-MINT<br>7.4.Publikimi i thirrjes për përkrahjen financiare të NMVM-ve në sektorin e Industrisë Kreative. Kjo skemë zhvillohet në kuadër të bashkëfinancimit ndërmjet MINTI-t, përmes KIESA-s dhe Qeverisë së Dukatit të Madh të Luksemburgut si dhe zbatohet në bashkëpunim me UNDP-në<br>7.5. Publikimi i Thirrjes për Propozime "Programi për Zhvillim Rajonal të Balancuar PZHRB 2026" nga Ministria e Zhvillimit Rajonal(MZHR)<br>7.6. Hartimi i orarit të barnatoreve për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës për ditët e punës, të dielave dhe festave zyrtare, për | Vazhdue-shme | Drejtori, Udhëheqësi dhe stafi DZHE |

| Nr. | Objektivat | Aktivitetët | Afati | Bartës të akt. |
| --- | --- | --- | --- | --- |
| | | subjektet afariste që janë furnizues të përditshëm për qytetarët me medikamente mjekësore;<br>7.7.Promovimi përmes OJQ-ve<br>7.8. Promovimi përmes rrjeteve sociale. | | |
| 8 | Realizimi i buxhetit për vitin 2024 | 8.1.Kërkesat fillestare të buxhetit për vitet në vijim.<br>8.2.Kërkesat për zotim.<br>8.3.Bashkangjitja e raporteve<br>8.4.Dorzimi për pagës | Janar-Dhjetor | Drejtori, Udhëheqsi dhe stafi DZHE |

## Drejtoria për Infrastrukturë Publike

| Nr. rendor | Objektiva | Aktiviteti | Afati | Bartës i aktivitetit |
|---|---|---|---|---|
| I. | **Informimi i palëve** | Punë administrative të ndryshme në bazë të repartit të drejtorisë; hartim të paramasave, menaxhim projektev, menaxhim buxhetit, komisione, punë me palë<br>Pranimi i lëndëve (kërkesave) të ndryshme nga palët 211<br>Në proces 77<br>Aprovuara 118<br>Refuzura 10<br>Anuluar 4<br>Pëlqime infrastrukturore 10<br>Refuzim të pëlqimeve infrastrukturore 3 | Janar - Qershor | Drejtoria për Infrastrukturë Lokale |
| -II- | **Zhvillimi i ıfrastrukturës ,okale** | Ndërtimi i kapacitetit të ujësjellësit – faza II; kyçje individuale në fshatin Korroticë e Epërme 187kycje dhe Qikatove e re<br>"Ndërtimi I rrugëve fushore në Komunë -Drenas, Tërstenik, Komoran, Dobroshec, Baicë dhe Arllat – projekt dy vjeçar L=3,000m'.<br>Ndërtimi i rrjetit të kanalizimit- L=4,000m'.<br>"Ndriçimi publik - L=10,000m'.<br>"Rehabilitimi i rrugës dhe ndërtimi I trotuarit Arllat – Negroc – Vuqak" projekt në vazhdim. "Ndërtimi dhe zgjerimi i sheshit "Fehmi dhe Xhevë Lladrovci"- projekt në vazhdim.<br>"Zgjerimi dhe rikonstruktimi i rrugës Fehmi dhe Xhevë Lladrovci".<br>"Asfaltimi i rrugëve dhe kubzimi Drenas I,II,III dhe IV - L=1250m'- projekt në vazhdim.<br>Hapja e kanaleve kulluese pergjatë rrugëve Drenas, Komoran, Arllat, Terstenik, Dobroshec dhe Baicë- projekt në vazhdim.<br>"Asfaltimi i rrugës në fsh. Gradicë- Likoshan-projekt në vazhdim. | Janar - Qershor | Drejtoria për Infrastrukturë Lokale |
| -III- | **Menaxhimi i projekteve** | Janë përfshirë zyrtarët e drejtorisë së infrastrukturës i cili si proces ka planifikimin, organizimin, drejtimin si dhe kontrollin.<br>Ky proces është i rëndësishëm për përmirësimin e cilësisë së jetës së qytetarëve përmes zhvillimi të qëndrueshëm të infrastrukturës. | Janar - Qershor | Drejtoria për Infrastrukturë Lokale |

## Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale

Në periudhën raportuese janar-qershor 2026, në Zyrën e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, janë regjistrua përmes intranetit të brendshëm (arkivit aktiv) 774 lëndë të ndryshme, ku prej tyre 527, janë miratuar, 231, janë në proces për shkak të afateve kohore, 10, janë refuzuar dhe 1 është anuluar, 1 anuluar dhe 4 tek rubrika pranuar.

Janë pranuar kërkesa dhe lëndë të natyrave të ndryshme socio-shëndetësore, drejtuar pranë drejtorisë tonë më konkretisht kemi pranuar kërkesa për ndërtim, për subvencionimin e personave fizike për shërim-rehabilitim, subvencionimi i lehonave, thirrje publike për OJQ, kërkesa për renovim/rindërtim të shtëpive, vërtetima, kërkesa për miell, pagesa të qirasë jo profitabile për banesa sociale si dhe kërkesa të tjera të cilat kanë qenë të lidhura me DSHMS-së.

Janë nxjerrë 189, vendime për subvencionimin e personave për shërim/rehabilitim mjekësor, prej tyre 5, janë të refuzuara. Kurse për subvencionimin e lehonave janë hartuar 165, vendime për kërkesat e aprovuara të tyre, është subvencionuar OJQ Handikos me 5,000.00 euro.

Në kuadër të implementimit të Projektit të Banimit Social Adekuat është shpallur lista e përfituese gjithësej 4 përfitues dhe lista e pritjes në të cilën i është dhënë kohë për plotësim të dokumentaciove pronësore 6 muaj ku janë gjithësej 29 familje në këtë listë, 9 familje janë tërhequr nga aplikimi për shkak të pamundësisë së rregullimit të dokumentacionit dhe 13 aplikues janë refuzuar nga komisioni të cilët nuk i kanë plotësuar kriteret e thirrjes publike.

Është hapur thirrja publike për Bonus Banim në të cilën ka aplikuar vetëm një familje e cila është ende në proces të shqyrtimit të dokumentacionit nga komisioni vlerësues.

Gjithashtu kanë filluar pagesat e qirasë jo profitabile nga shfrytëzuesit e banesave sociale ku deri me tani gjithësej janë lëshuar 75 fletëpagesa dhe janë paguar për qira jo profitabile 2,404.73 euro.

Në bashkëpunim me OJQ janë ndihmuar familje në nevojë me pako ushqimore dhe veshmbathje ku janë përfshirë 680 familje me pako ushqimore dhe 50 familje me veshëmbathje me vlerë prej 100 euro ka shoqatat humanitare në bashkëpunim me QPS dhe DSHMS në përzgjedhjen e familjeve në nevojë.
Gjatë kësaj periudhe raportuese janë iniciuar procedura për prokurim ku janë zhvilluar procedura për projektet e KPSH-së:

Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale

*Raporti i punës Janar – Qershor 2026*

| Nr. r. | Objektiva | Aktiviteti | Afati | Bartës akti. |
|---|---|---|---|---|
| **-I-** | **Përmirësimi i cilësisë së shërbim. Shëndetës .primare** | 9. Monitorimi i punës së Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare, QMF dhe AMF-ve dhe mbikëqyrja e zbatimit të standardeve profesionale në ofrimin e shërbimeve.<br>10. Organizimi i takimeve koordinuese me menaxhmentin e institucioneve shëndetësore. | Vazhdueshme<br><br>Çdo dy javë | DSHMS |

| Nr. r. | Objektiva | Aktiviteti | Afati | Bartës akti. |
|---|---|---|---|---|
| | | 11. Ofrimi i shërbimeve shëndetësore cilësore në Qendrat e Mjekësisë Familjare dhe AMF, | vazhdueshme | KPSH |
| | | 12. Identifikimi, planifikimi dhe furnizimi i institucioneve shëndetësre me barna, material shpenzues dhe pajisje mjekësore. | Çdo 3 muaj furnizimi me barna, ndersa paisje sipas projekteve të planifikura | Depoja e barnatores së QKMF dhe DSHMS |
| II-<br><br>III - | **Promov. dhe edukimi për shëndetin publik** | 13. Mirëmbajtja dhe përmirësimi i infrastrukturës së objekteve shëndetësore.<br>14. Numri i vizitave në KPSH-67058, ndërsa numri i shërbimeve 144775<br>15. Zbatimi i shërbimeve të vizitave shtëpiake për gratë shtatëzana dhe femijet deri 3 vjeq | Sipas projekteve të planifikuara Shenja e shërbimeve shëndetësore | QKMF dhe DSHMS |
| | | 1. Organizimi i fushatave ndërgjegjësuese për shëndetin dhe shënimi i ditëve ndërkombëtare të shëndetit. | Sipas kalendarit të ditëve nderkombëtare | Kordinator i i ZHVP |
| | **Menaxhimi efikas i burimeve financiare dhe njerëzore** | 2. Përformanca Komunale -Treguesit e Fushës tek Përfaqësimi Gjinor (10 indikatorë),si dhe fusha Barazia në Punësim, Shërbimet Sociale dhe Familjare me gjithësej 4 indikatorë | Gjatë periudhës raportuese në SIMPK, janë futur të gjitha të dhënat që kanë qenë nga të dy fushat nga \yrtarja e caktuara e DSHMS | Zyrtari raportues |
| | | 3. Ligjërata edukative në shkolla dhe komunitet (karvani shëndetësor) | | QKMF |
| IV - | | 4. Bashkëpunim me institucionet shëndetësore dhe organizatat partnere.<br>5. Donacion (inkubator, transportues, shtrat gjinekologjik ) nga AMC<br>6. Rekrutimi i 16 profesionistëve shëndetësorë | Takime me Ministrinë e Shëndetësisë. Bashkëpunim me donatorët dhe organizatat ndërkombëtare. | DSHMS, QKMF |
| | | 1. Monitorimi i realizimit të buxhetit. | Përgatitja e projekt-propozimeve për investime. | DSHMS, QKMF |

<table>
<tr><th>Nr. r.</th><th>Objektiva</th><th>Aktiviteti</th><th>Afati</th><th>Bartës akti.</th></tr>
<tr><td rowspan="5"></td><td rowspan="5">Përmirë. i shërbim. të mirëqenies sociale</td><td>1. Hartimi i planeve të prokurimit, dhe projektet e shpallura:<br>• Rregullimi I kamerave në QKMF Drenas dhe Komoran<br>• Bartja e pacienteve me hemodializë<br>-Sigurimi i automjeteve për QKMF dhe QPS<br>• Furnizim me material zyrtar administrativ<br>• Furnizim me material shpenzues për analiza Hematologjike dhe Biokimike<br>• Mirëmbajtja e pajisjeve mjekësore –aparaturave<br>• Furnizim me dokumente shëndetësore<br>• Furnizim me oksigjen medicinal<br>• DDD për KPSH</td><td>Koordinimi me drejtoritë komunale dhe institucionet relevante.</td><td>QKMF dhe DSHMS</td></tr>
<tr><td>2. Monitorimi i kontratave dhe shpenzimeve. (kontratave për shërbime, për furnizime, për mirëmbajtje të pajisjeve, etj)</td><td>Menaxherët e kontratave.</td><td>DSHMS, QKMF</td></tr>
<tr><td>3. Menaxhimi i burimeve njerëzore dhe koordinimi i stafit.</td><td>Planifikimi i pushimeve, verësimet, planet e punës, raportet</td><td>Udhëheqësi i drejtorisë</td></tr>
<tr><td>1. Bashkëpunim me Qendrën për Punë Sociale.<br>2. Ligjeratat e planifikuara nga ZHVP dhe të akredituara nga OMK dhe OIM</td><td>Koordinimi me DSHMS dhe QKMF për trajtimin e rasteve të shërbimeve sociale</td><td>DSHMS,QPS</td></tr>
<tr><td>3. Mbështetje për familjet në nevojë Koordinim me organizatat joqeveritare dhe institucionet partnere.sociale.</td><td>Dhënja e donacioneve për familjet në nevojë 680 pako ushqimore, 50 familje për veshë</td><td>ZKP dhe Zyra e Prokurimit</td></tr>
<tr><td>V-</td><td></td><td>4. Trajtimi i rasteve sociale sipas procedurave ligjore.
<table>
<tr><th>Nr.</th><th>Muaj</th><th>Nr.i Familj.</th><th>Nr.i anët. të Familjes</th><th>Shuma në euro</th></tr>
<tr><td>1</td><td>Janar</td><td>561</td><td>2464</td><td>90.348.00</td></tr>
<tr><td>2</td><td>Shkurt</td><td>556</td><td>2454</td><td>90.132.00</td></tr>
<tr><td>3</td><td>Mars</td><td>552</td><td>2437</td><td>89.532.00</td></tr>
<tr><td>4</td><td>Prill</td><td>541</td><td>2374</td><td>87.084.00</td></tr>
<tr><td>5</td><td>Maj</td><td>543</td><td>2379</td><td>88.332.00</td></tr>
<tr><td>6</td><td>Qershor</td><td>539</td><td>2348</td><td>86.352.00</td></tr>
</table></td><td>Verifikimi në teren dhe plotësimi i dosjeve</td><td>QPS</td></tr>
</table>

| Nr. r. | Objektiva | Aktiviteti | Afati | Bartës akti. |
|---|---|---|---|---|
| | | 4. Mbështetje për personat me aftësi të kufizuara dhe kategoritë e cenueshme. | Përfitimi për kategoritë e cenushme përmes subnvencioneve, donacioneve | DSHMS |
| | | Monitorimi i pagesave të qirasë jo profitabile sipas kontratatve të shfrytëzuesve të banesave sociale | Lëshimi i fletëpagesave për qiranë jo profitabile:<br>Janar, 17 fatura-802.15<br>Shkurt, 12 fatura-356.22<br>Mars, 13 fatura-329.78<br>Prill, 9 fatura 259.43<br>Maj,14 fatura -436.73<br>Qershor, 10 fatura -220.42<br>Gjithësej janë lëshuar 75 fletëpagesa dhe janë paguar për qira jo profitabile 2,404.73 | Zyrtari i banimit social |

## Drejtoria e Inspeksionit

Drejtoria e Inspekcionit gjatë periudhës janar – qershor 2026 ka realizuar aktivitetet e saj në përputhje me legjislacionin në fuqi, planin e punës së komunës dhe kompetencat e përcaktuara për secilin sektor inspektues. Aktivitetet janë orientuar në mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve dhe rregulloreve komunale, mbrojtjen e interesit publik, ruajtjen e rendit urbanistik, mbrojtjen e mjedisit, sigurinë në komunikacion dhe përmirësimin e shërbimeve publike.

1. Aktivitetet e Inspektoratit të Tregut
Gjatë kësaj periudhe janë realizuar inspektime të rregullta dhe të jashtëzakonshme në subjektet afariste që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin e komunës.

Aktivitetet kryesore:

* Kontrolli i dokumentacionit të bizneseve.
* Verifikimi i licencave dhe lejeve të punës.
* Kontrolli i respektimit të orarit të punës.
* Inspektime sipas ankesave të qytetarëve.
* Bashkëpunim me institucionet relevante për evidentimin e veprimtarive të paligjshme.

Rezultatet:

* Janë realizuar 96 inspektime.
* Janë hartuar 72 procesverbale.
* Janë shqiptuar 33 gjoba.
* Vlera e gjobave 6210 euro.

2. Aktivitetet e Inspektoratit të Ndërtimit
Inspektori i Ndërtimit ka zhvilluar kontrolle të vazhdueshme për monitorimin e punimeve ndërtimore dhe respektimin e dokumentacionit urbanistik.

Aktivitetet kryesore:

* Inspektimi i objekteve në ndërtim.
* Verifikimi i posedimit të lejeve ndërtimore.
* Kontrolli i respektimit të kushteve të lejeve.
* Evidentimi i ndërtimeve pa leje.
* Ndërmarrja e masave administrative sipas legjislacionit.

Rezultatet:

* Janë realizuar 86 inspektime.
* Janë hartuar 62 procesverbale.
* Janë hartuar 14 aktvendime për ndalje të punimeve.
* Janë hartuar 6 gjoba.
* Vlera e gjobave 6000 euro.

3. Aktivitetet e Inspektoratit të Mjedisit

Aktivitetet janë fokusuar në mbrojtjen e mjedisit, menaxhimin e mbeturinave dhe parandalimin e ndotjes.

Aktivitetet kryesore:

* Inspektimi i hapësirave publike.
* Kontrolli i menaxhimit të mbeturinave.
* Monitorimi i deponive ilegale.
* Inspektime lidhur me ndotjen e ajrit, ujit dhe tokës.
* Sensibilizimi i qytetarëve për mbrojtjen e mjedisit.

Rezultatet:

* Janë realizuar 83 inspektime.
* Janë hartuar 65 procesverbale
* Janë shqiptuar 5 gjoba
* Vlera e gjobave 650 euro.

4. Aktivitetet e Inspektoratit të Komunikacionit
Inspektori i Komunikacionit ka kryer monitorimin dhe mbikëqyrjen e transportit publik dhe qarkullimit rrugor brenda kompetencave komunale.

Aktivitetet kryesore:

* Kontrolli i transportit publik.
* Verifikimi i stacioneve dhe vendndalesave.
* Kontrolli i respektimit të itinerareve dhe orareve.
* Inspektimi i automjeteve që operojnë në transport publik.
* Trajtimi i ankesave të qytetarëve.

Rezultatet:

* Janë realizuar 94 inspektime.
* Janë hartuar 72 procesverbale.
* Janë shqiptuar 10 gjoba.
* Vlera e gjobave 1400 euro.

5. Aktivitetet e Inspektoratit të Shërbimeve Publike
Inspektori i Shërbimeve Publike ka monitoruar ofrimin e shërbimeve publike dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës komunale.

Aktivitetet kryesore:

* Kontrolli i mirëmbajtjes së rrugëve lokale.
* Mbikëqyrja e ndriçimit publik.
* Kontrolli i hapësirave publike.
* Monitorimi i kompanive që ofrojnë shërbime publike.
* Trajtimi i kërkesave dhe ankesave të qytetarëve.

Rezultatet:

* Janë realizuar 85 inspektime.
* Janë hartuar 64 procesverbale
* Janë shqiptuar 20 gjoba
* Vlera e gjobave 6250 euro.

6. Sfidat e hasura

Gjatë periudhës raportuese janë identifikuar këto sfida:

* Numri i kufizuar i personelit inspektues.
* Rritja e numrit të ankesave të qytetarëve në mënyrë verbale.
* Ndërtimet pa leje në zona të caktuara.
* Menaxhimi i deponive ilegale.

7. Objektivat për Gjashtëmujorin e Dytë

* Rritja e numrit të stafit dhe inspektimeve në terren.
* Përmirësimi i bashkëpunimit ndërinstitucional.
* Fuqizimi i monitorimit të ndërtimeve pa leje.
* Intensifikimi i aktiviteteve për mbrojtjen e mjedisit.
* Efikasiteti në trajtimin e ankesave të qytetarëve.

8. Përfundim

Drejtoria e Inspekcionit gjatë periudhës janar–qershor 2026, ka realizuar detyrat dhe përgjegjësitë e saj në përputhje me kompetencat ligjore. Në përgjithësi janë realizuar 456 inspektime, 347 procesverbale dhe 73 gjoba(20 510 euro). Përmes inspektimeve të vazhdueshme dhe ndërmarrjes së masave administrative është kontribuar në rritjen e rendit dhe ligjshmërisë në territorin e komunës. Drejtoria do të vazhdojë angazhimin për përmirësimin e shërbimeve dhe mbrojtjen e interesit publik gjatë gjashtëmujorit të ardhshëm.

## Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit

Gjatë periudhës janar–qershor 2026, Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit (DUMM) ka zhvilluar aktivitetet e saj në përputhje me objektivat strategjike të Komunës së Drenasit, planin e punës, kornizën ligjore në fuqi dhe nevojat e qytetarëve, duke u fokusuar në krijimin e një mjedisi urban më funksional, të qëndrueshëm dhe miqësor për komunitetin.

Përmes një qasjeje proaktive, transparente dhe të orientuar drejt rezultateve, Drejtoria ka avancuar proceset e planifikimit urban, ka avancuar në trajtimin e lendeve për legalizimin e objekteve të ndërtuara pa leje sipas ligjit mbi Legalizimin, ka përmirësuar efikasitetin e shërbimeve administrative dhe ka intensifikuar veprimet për mbrojtjen dhe menaxhimin e qëndrueshëm të mjedisit. Kjo periudhë është karakterizuar nga realizimi i një sërë aktivitetesh dhe iniciativash me ndikim të drejtpërdrejtë në zhvillimin e qëndrueshëm të komunës, duke reflektuar përkushtimin institucional për ofrimin e shërbimeve cilësore si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së jetës së qytetarëve.

Aktivitetet kryesore të realizuara

Gjatë periudhës raportuese janar–qershor 2026, Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit ka zhvilluar aktivitetet e saj në përputhje me planin vjetor të punës, prioritetet strategjike të Komunës së Drenasit dhe kërkesat e qytetarëve. Përmes një qasjeje profesionale dhe të orientuar drejt rezultateve, Drejtoria ka siguruar ofrimin efikas të shërbimeve administrative, avancimin e proceseve të planifikimit urban dhe forcimin e masave për mbrojtjen e mjedisit. Aktivitetet kryesore të realizuara gjatë kësaj periudhe përfshijnë:

1. Planifikimi hapësinor dhe legalizimi

- Trajtimin e kërkesave për legalizimin e ndërtimeve pa leje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe procedurat e përcaktuara ligjore të zgjatura deri me 31 dhjetor 2026.
- Shqyrtimin dhe lëshimin e lejeve ndërtimore për objektet e kategorisë I dhe II, duke siguruar përputhshmërinë e tyre me dokumentet e planifikimit hapësinor të dhe legjislacionit në fuqi;
- Lëshimin e certifikatave të përdorimit për objektet që kanë përmbushur të gjitha kriteret teknike dhe ligjore për funksionalizim.
- Ofrimin e këshillimit profesional për qytetarët dhe investitorët lidhur me procedurat urbanistike dhe ndërtimore.

2. Mbrojtja e Mjedisit

- Lëshimin e Lejeve Mjedisore Komunale (LMK) dhe mendimeve profesionale për aktivitetet dhe objektet që mund të kenë ndikim në mjedis.
- Zbatimin dhe monitorimin e procedurave administrative për respektimin e standardeve dhe kërkesave mjedisore në nivel lokal.
- Mbikqyrjen dhe mirëmbajtjen e hapësirave të gjelbëruara në përputhje me planin e punës dhe objektivat për zhvillim të qëndrueshëm.
- Realizimin e aktiviteteve sensibilizuese dhe praktike për mbrojtjen e mjedisit, ruajtjen e biodiversitetit dhe promovimin e një mjedisi më të pastër për qytetarët.

3. Emërtimi i rrugëve dhe regjistrimi i adresave

- Vazhdimin e projektit për sistemimin e adresave zyrtare përmes vendosjes së tabelave me emra rrugësh dhe numrave të objekteve në të gjithë territorin e komunës.
- Harmonizimin e të dhënave me Sistemin e Regjistrit të Adresave (ARIS) dhe përditësimin e tyre në përputhje me evidencat e gjendjes civile.

4. Shërbime të tjera në fushën e urbanizmit

- Lëshimin e pëlqimeve urbanistike për ndarje dhe bashkim parcelash, ndërtimin e objekteve bujqësore dhe ndryshimin e destinimit të tokës.
- Përgatitjen e dokumentacionit teknik dhe administrativ për komisione të ndryshme komunale, përfshirë proceset e vlerësimit, mbikëqyrjes teknike dhe hartimit të dokumenteve zhvillimore.
- Ofrimin e mbështetjes profesionale në proceset e planifikimit dhe zhvillimit të projekteve me interes publik.

III. Statistikat (janar-qershor 2026)

| **Aktiviteti** | **Sasia** |
|---|---|
| Kërkesa për Leje Ndërtimore | 27 |
| Refuzim të Lejes Ndërtimore | 17 |
| Leje Ndërtimore për objekte të kategorisë I dhe II | 10 |
| Vendime për Listë të Pritjes për objekte të ndërtuara pa leje | 70 |
| Vendime për Legalizim të objekteve të ndërtuara pa leje | 19 |
| Certifikata e Legalizimit për Objekte të Ndërtuara pa Leje | 61 |
| Certifikata të Përdorimit për objekte qe posedojnë Leje ndërtimore | 7 |
| Aktvendime për ndërrim destinimi të tokës sipas legjislacionit | 9 |
| Dhënie e pronave në shfrytëzim për me pak së një vit | 19 |
| Pelqim për vendosjen e panelave solare mbi objekte banimi | 6 |
| Aktvendime për pelqime urbanistike dhe qasje në rrugë | 4 |
| Certifikata të adresave në kuader të projektit “Ndërlidhja e qytetarit me adresen zyrtare” | 593 |
| Numra të rinj adresash të vendosur në terren | 52 |

Arritjet dhe përmirësimet gjatë periudhës

- Digjitalizimi dhe përditësimi i të dhënave në sistemin ARIS dhe sinkronizimi me gjendjen civile.
- Përmirësimi i procedurave të aplikimit për leje ndërtimit

- Pjesëmarrje aktive në hartimin e strategjive zhvillimore komunale
- Përkrahja e iniciativave zhvillimore me rëndësi për komunën.

Përfundim

Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit ka realizuar me sukses shumicën e objektivave për gjashtëmujorin e parë të vitit 2026, duke kontribuar në përmirësimin e infrastrukturës urbane, rritjen e transparencës dhe fuqizimin e shërbimeve publike për qytetarët e Komunës së Drenasit. Përgjatë pjesës së mbetur të vitit, drejtoria synon të vazhdojë me intensitet të njëjtë në përmbushjen e detyrave dhe implementimin e planeve zhvillimore.

Deri me datë 17.06.2026 Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit ka inkasuar të hyra në vlerë prej 156,703.53 € ose shprehur në përqindje 115.15%. Kjo tejkalon planin për periudhen raportuese dhe reflekton rritje të efikasitetit në menaxhimin operativ të DUMM.

Në pjesën e mbetur të vitit do të vazhdojmë punën sipas Planit të Punës, duke u siguruar për zbatimin e ligjeve, rregulloreve, udhëzimeve administrative, si dhe të të gjitha dokumenteve strategjike që ka komuna jonë. Drejtoria e Urbanizmit dhe zyrtarët e saj, edhe përkundër vështirësive dhe numrit të kufizuar të zyrtarëve, do të vazhdojnë të kryejnë detyrat me përgjegjësi të lartë dhe përkushtim, në shërbim të qytetarëve.

## Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural

Raporti gjashtëmujor është paraqitur me objektiva, aktivitete, bartës të aktiviteteve, me afate kohore.

| Nr. | Objektivat | Aktivitetet | Afati | Bartës të aktiviteteve |
|---|---|---|---|---|
| 1. | Përgatitja e raportit vjetor të punës-2025 | 1.1. Mbledhja e të dhënave,<br>123. Përgatitja e të dhënave lidhur me raportin,<br>1.3. Përpunimi final i raportit. | Janar | Stafi<br>Udhëheqësi<br>Drejtori |
| 2. | Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet/ Komuna e Drenasit me Islamic Relief Worldwide(IRW) | 2.1.Ështe bërë njoftimi për thirrjen publike për mekanizim në bujqësi,<br>2.2.Është formuar komisioni,<br>2.3.Është bërë kontrollë administrative e lëndeve. | Prill | Komisioni<br>Udhëheqësi<br>Drejtori |
| 3. | Regjistrimi i fermerëve në regjistrin e fermës | 3.1.Pajisja e fermerëve me formular–Aneks<br>3.2. Pajisja e fermerëve me çertifikatë të fermerit-Nif. | Gjatë vitit | Stafi,<br>Udhëheqësi |
| 4. | **Realizimi i mbjelljeve pranverore** | **4.1. Monitorimi në terren për të verifikuar realizimin e mbjelljeve pranverore.**<br>**4.2 Përgatitja e formulareve dhe raportimi për planifikimin dhe realizimin e të mbjellurave pranverore në MBPZHR.** | Maj | Stafi përkates<br>Udhëheqsi<br>Drejtori |
| 5. | **Vlerësimi i dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkëqësit tjera** | 5.1. Komisioni i caktuara **nga zyra e Kryetarit kryen këto punë:**<br>**Pranon** kërkesat për dëmet e shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera,<br>5.2.Dalja në teren, për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara,<br>5.3. Komisioni përgatit raporte individuale i përmbledh në raport përfundimtar dhe së bashku me lëndet fizike i përcjell në nivel qëndror për kompensim. | Gjatë vitit | Komisionet përkatëse |
| 6 | **Kërkesat për ndarjen e buxhetit si dhe realizimi i shpenzimit sipas planifikimit gjatë vitit aktual si dhe përcjellja e faturave për pagesë** | 6.1. Hartimi i këkesave fillestare për buxhet për tri vitet në vijim<br>6.2. Kërkesat për zotime<br>6.3.Bashkëngjitja e raporteve<br>6.4. Dorëzimi për pagesë | Gjatë vitit | Stafi përkates<br>Udhëheqësi<br>Drejtori |

## Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport

| | |
|---|---|
| **Aktivitetet kulturore** | Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit ka realizuar në tërësi plan-programin e vet të punës në periudhën Janar- Qershor<br>- Përgatitja e raportit vjetor të DKRS për vitin 2025;<br>- Vlerësimi i punëtorëve për vitin 2025;<br>- Raporti gjashtëmujor për vitin 2026;<br>- Takime individuale dhe kolektive me punëtorët e DKRS-së;<br>- Organizimi dhe mbështetja e aktiviteteve kulturore, sportive dhe përkujtimore: 18 vjetori i Pavarësisë së Kosovës, 27 vjetori i Ditës së Çlirimit të Drenasit, Sofra Poetike “Ymer Elshani”, promovime letrare, përkrahja për turnire memoriale sportive për nder të dëshmorëve, ceremoni përkujtimore;<br>- Përgatitje e kërkesave fillestare për Buxhet të DKRS-së 2027-2029;<br>- Pranimi dhe procedimi brenda afatit i 270 lëndëve në sistemin Intranet;<br>- Realizimi i procedurave për subvencionimin e Organizatave Joqeveritare (OJQ), duke përfshirë shpalljen e thirrjes publike, vlerësimin e aplikacioneve, publikimin e listës së përfituesve dhe përgatitjen e vendimeve dhe marrëveshjeve për mbështetje financiare;<br>- Bashkëfinancim me UNDP dhe Bashkimin Evropian në Programin ReLOaD3 për përkrahje ndaj OJQ;<br>- Vazhdimi i procedurave për realizimin e fazave të radhës të Stadiumit të Qytetit “Rexhep Rexhepi”;<br>- Zhvillimi i procedurave për realizimin e tri fushave sportive në Arllat, Komoran dhe Korroticë të Epërme;<br>- Takime dhe koordinime me Ministrinë e Sportit dhe Rinisë, Federatën e Futbollit të Kosovës, UEFA-n, me Agjencinë Shtetërore të Arkivave të Kosovës (ASHAK) dhe institucione të tjera relevante, me fokus zgjerimin e investimeve në infrastrukturën sportive dhe krijimin e mundësive të reja për zhvillimin e kulturës, rinisë dhe sportit në komunën tonë;<br>- Pasurimi i fondit bibliotekar me libra të rinj;<br>- Menaxhimi dhe mirëmbajtja e vazhdueshme e objekteve sportive dhe kulturore përmes vizitave, inspektimeve dhe ndërhyrjeve për përmirësimin e kushteve të shfrytëzimit.<br><br>Punë Administrative të Përgjithshme në kuadër të DKRS-së<br><br>• Mbajtja e protokollit të brendshëm për Drejtorinë dhe të gjithë sektorët përkatës në kuadër të DKRS-së (kulturë, rini, sport);<br>• Pranimi dhe administrimi i faturave dhe kërkesave të ndryshme që i drejtohen DKRS-së;<br>• Përpunimi dhe administrimi i lëndëve të DKRS-së në sistemin e Intranetit 270 gjatë kësaj periudhe;<br>• Përgatitja dhe dorëzimi i kërkesave për nevoja të ndryshme të DKRS-së, duke përfshirë edhe procedurat për pagesë;<br>• Skanimi dhe arkivimi i dokumenteve të lëndëve zyrtare të DKRS-së;<br>• Përgatitja e raporteve për nevojat e Drejtorisë dhe përcjellja e lëndëve për pagesë të Drejtoria për Buxhet dhe Financa;<br><br>Detyra dhe Projekte shtesë<br><br>• Përgatitja dhe menaxhimi i të dhënave në format Excel për të gjitha OJQ-të kulturore, sportive dhe rinore - përfshirë ndërtimin e data bazës përkatëse;<br>• Hartimi i raporteve të komisionit për pranimin e mallrave të furnizuara për DKRS;<br>• Menaxhimi i kontratës “Furnizim me Buqeta Lulesh të Freskëta për Homazhe”, përfshirë: Plotësimi i procedurave përmes sistemit E-prokurim; |

Hartimi i planit të menaxhimit të kontratës; Përgatitja e lëndëve për pagesë dhe përcjellja në Drejtorinë për Buxhet dhe Financa;

- Menaxhimi i kontratës “Furnizim me hamburger dhe pije”;
- Menaxhimi i kontratës “Mirëmbajtja dhe pastrimi i Objektit të Komunës;
- Pjesëmarrje në Projektin e UNDP-së bashkë me anëtaret e tjerë të komisionit, në trajnimin e OJQ-ve për thirrjen publike nga UNDP-ReLOaD3;
- Kam bërë përgatitjen e paramasave të Projekteve për nevojat e DKRS-së;

- Operatori Teknik
- Ndihmon në organizimin dhe përgatitjen teknike për manifestimet kulturore, sportive dhe rinore;
- Kujdes në mirëmbajtjen e mjeteve të zërimit dhe Sallës së Kulturës, mban evidencë të kërkesave që vijnë nga jashtë dhe brenda për aktivitetet në sallë;
- Përgatitjen e Palestrës për aktivitetet sportive, mbajtjen e evidencave për terminët e klubeve dhe asistimi në organizimin e garave sportive;
- Shpërndarja e shkresave të ndryshme informuese për aktivitetet e DKRS-së;

Arkivi historik komunal

- 37 lëndë të pranuara përmes Intranetit, janë trajtuar 37 kërkesa të palëve, është lëshuar 1 certifikatë shkollore, janë shqyrtuar 2 kërkesa për ofrimin e vendimeve për objekte të caktuara, janë përgatitur 36 njoftime për palë dhe janë realizuar 2 hulumtime lidhur me Agroproduktin “Drenica”.
- Vizita ditore në objektin ku janë të vendosur dokumentet e arkivuara, pastrimi, ruajtja dhe klasifikim i dokumenteve;
- Skanimi i dokumenteve të ndërmarrjes ish objektin Drenica, skica plane dhe historikun rreth organizimit të saj;
- Njoftimi i Institutit Arkeologjik për vendimin mbi Zonën Mbrojtëse dhe përcaktimin e perimetrit të asetit të trashëgimisë arkeologjike “Kalaja e Llapushnikut”, si dhe procedurat për regjistrimin e saj në sistemin kadastral, në përputhje me Ligjin për Trashëgiminë Kulturore;
- Kryesimi i komisionit për hartimin e Rregullores dhe Listës së Dokumenteve me Afat Ruajtjeje në Komunën e Drenasit. Rregullorja u miratua nga Kuvendi Komunal, ndërsa Lista e Dokumenteve mori pëlqimin nga ASHAK;
- Pjesëmarrja në komisionin për vlerësimin e dëmeve nga vërshimet e datave 05.01.2026-08.01.2026, përfshirë daljen në terren, shqyrtimin e kërkesave dhe përpilimin e raporteve përkatëse;
- Pranimi dhe trajtimi i vendimeve nga Zyra e Prokurimit për negocimin e ofertës lidhur me projektin “Vazhdimi i fazës së dytë të Stadiumit Rexhep Rexhepi”;
- Përgatitja e vendimeve, propozim-vendimeve dhe marrëveshjeve për përfituesit e subvencioneve në fushën e sportit, kulturës dhe rinisë;
- Caktimi si zyrtar përgjegjës për monitorimin dhe implementimin e projekteve të subvencionuara në kuadër të programit ReLOaD3;
- Pjesëmarrja në komisionin për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për subvencionim jashtë thirrjes publike, sipas vendimit të Zyrës së Kryetarit.

Biblioteka “Ymer Elshani”- Drenas, Arllat, Tërstenik, Komoran-Raporti Janar-Qershor 2026

| Janar-Qershor 2026 | Nr.i ekzemp. | Nr.i titujve | Ekzmp. të ri. | Tituj të rinj | Libra të lexuar | Nr.i lexuesve | Lexues të ri | Gjithsej lexues |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Drenas | 11339 | 4495 | / | / | 93 | 78 | / | 78 |
| Arllat | 5931 | 1266 | / | / | 430 | 430 | / | 430 |
| Tërstenik | 6289 | 1844 | / | / | 215 | 343 | 24 | 343 |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Komoran | 7002 | 3668 | / | / | 30 | 30 | / | 30 |
| Gjithsej | 30,561 | 11,273 | / | / | 768 | 881 | 24 | 881 |

Rinia

- Kryerja e punëve administrative dhe detyrave zyrtare në zyrën e DKRS-së, si dhe trajtimi i kërkesave të ndryshme të Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit;
- Pranimi dhe trajtimi i email-eve zyrtare lidhur me kontratën e kompanisë JONI TRAVEL, në cilësinë e menaxherit të kontratës;
- Përgatitja e raporteve për transportin e nxënësve në shkolla, verifikimi i faturave dhe dokumentacionit përkatës;
- Koordinimi dhe mbikëqyrja e dekorimit të qytetit me flamuj për festën e 17 Shkurtit-Ditës së Pavarësisë dhe 14 Qershorit-Ditës së Çlirimit, në cilësinë e menaxherit të kontratës;
- Pjesëmarrja në komisionin për vlerësimin e dëmeve nga vërshimet dhe fatkeqësitë natyrore, përfundimi i raporteve dhe dorëzimi i dokumentacionit në komisionin qendror;
- Takim me zyrtaren e rinisë në Komunën e Ferizajt për diskutimin e iniciativave të përbashkëta në mbështetje të të rinjve;
- Pjesëmarrja në grupin punues për planifikimin, organizimin dhe dokumentimin e dëgjimeve buxhetore për vitin 2027 dhe projeksionet për vitet 2028-2029.

Sporti

- Është hartuar Plani i Punës për vitin 2026;
- Mbledhja e raporteve të punëtorëve në tri objekte sportive;
- Përgatitja e raporteve për objektet sportive për DKRS-në;
- Mbajtja e garave në pjesën finale, fituesit e grupeve në Palestrën sportive “Hysni Jetullahu’’ në lojën e Futsallit për ShFMU dhe ShML (V&D);
- Mbajtja e garave në pjesën finale, fituesit e grupeve në Palestrën sportive “Hysni Jetullahu’’ në lojën e Volejbollit për ShFMU dhe ShML (V&D);
- Mbajtja e garave në pjesën finale, fituesit e grupeve në Palestrën sportive “Hysni Jetullahu’’ në lojën e Basketbollit për ShFMU dhe ShML (V&D);
- Gjithsejtë në këto gara nga SHFMU-të për kategorinë e vajzave dhe djemve kanë marrë pjesë 30 ShFMU, dhe 2 (dy) ShM;
- Turniri memorial kushtuar futbollistit të KF Feronikeli “Rexhep Rexhepi” në përvjetorin e vrasjes së tij, i cili u mbajt në fushën Sintetike në Drenas në futboll të madh;
- Turniri i organizuar për nder të ditës së çlirimit të Drenasit i cili u mbajt në palestrën “Gjergj Kastrioti Skënderbeu” me mësimdhënësit e shkollave të mesme “Gjergj Kastrioti Skënderbeu” dhe “Fehmi Lladrovci” dhe në stadiumin “Rexhep Rexhepi” ndërmjet zyrtarëve të Komunës së Drenasit dhe veteranëve të FC Feronikelit;
- Përkrahja me topa dhe rekuizita sportive për turnirët: Tre Heronjtë e fshatit Nekoc, Dëshmorët e Qyqavicës, Dëshmorët e Korroticës së Epërme, Dëshmori “Abedin Bujupi”.

Objektet Sportive-Palestra e Sportit “Hysni Jetullahu”, Stadiumi Sintetik Drenas, Stadiumi “Rexhep Rexhepi”, Stadiumi Sintetik Zabel i Ulët- Raporti Janar-Qershor, 2026

| Objektet Sportive | Nr. i stërvitjeve | Orë | Nr.i Pjesëm. (lojëtarë dhe staf) | Nr. i shikuesve | Lojë kampionale |
|---|---|---|---|---|---|
| Palestra e Sportit “Hysni Jetullahu” | 206 | 546 | 4278 | 6265 | 47 |
| Stadiumi Sintetik-Drenas | 631 | 1202 | 17233 | 4110 | 84 |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| Stadiumi "Rexhep Rexhepi" | 88 | 176 | 2792 | 10600 | 11 |
| Stadiumi Sintetik Zabel i Ulët | 10 | 20 | 300 | 0 | 0 |
| Gjithesejt | 935 | 1944 | 24603 | 20975 | 142 |

Objektivë e DKRS-së mbetet realizimi i planit në përpikëri për gjashtë mujorin e dytë - 2026;

• Përfundimi i projekteve për ndërtimin e fushave sportive dhe funksionalizimi i tyre për qytetarët;

• Vazhdimi i ndërtimit të fazës së tretë të stadiumit të qytetit "Rexhep Rexhepi";

• Koordinimi dhe monitorimi i zbatimit të projekteve të organizatave përfituese nga subvencionet e DKRS-së dhe Programi ReLOaD3;

• Organizimi i aktiviteteve kulturore dhe përkujtimore me rastin e 28 Nëntorit, Kongresit të Manastirit, ceremonisë "Sportisti i Vitit" dhe festave të fundvitit;

• Bashkëpunimi dhe koordinimi me Drejtorinë Komunale të Arsimit për organizimin e aktiviteteve sportive shkollore;

• Inicimi i procedurave për ndërtimin e teatrit të qytetit dhe themelimin e trupës teatrore komunale.

## Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë

Raporti i punës Janar –Qershor 2026

| Nr. rendor | Objektiva | Aktiviteti | Afati | Bartës i aktivitetit |
|---|---|---|---|---|
| -I- Gjeodezi | Ndarje Parcelave, Bashkim parcelave, Modifikim i atributeve të parcelave, Regjistrim objekteve, Kopje plani dhe vektor-koordinata të parcelave | 1. Ndarje e parcelave: 96 | 01.2026 deri 06.2026 | Sektori i Gjeodezisë |
| | | 2.Bashkim i parcelave: 38 | 01.01.2026 deri 06.2026 | Sektori i Gjeodezisë |
| | | 3.Regjistrim i objekteve-ndërtesave: 70 | 01.2026 deri 23.06.2026 | Sektori i Gjeodezisë |
| | | 3.Regjistrim i pjesëve të ndërtesave | 01.2026 deri 06.2026 | Sektori i Gjeodezisë |
| | | 5.Modifikim i atributeve të parcelës: 41 | 01.2026 deri 06.2026 | Sektori i Gjeodezisë |
| -II- Kadastër | Bartje e pronave: Blerje, Dhurim, Këmbim, Trashëgimi, Fshirja e ngarkesave tatimore, Regjistrimi i qirambajtjesë, Regjistrimi dhe fshirja e Hipotekave, nxjerrja e certifikatës të pronës etj. | 1. Bartja e posedimit – Blerje: 205 | 01.2026 deri 06.2026 | Sektori i Kadastrit |
| | | 2. Bartja e posedimit – Dhurim:181 | 01.2026 deri 06.2026 | Sektori i Kadastrit |
| | | 3.Bartje e posedimit-kembim: 9 | 01.2026 deri 06.2026 | Sektori i Kadastrit |
| | | 4.Bartje e posedimit-trashëgimi: 75 | 01.2026 deri 06.2026 | Sektori i Kadastrit |
| | | 5.Bashkimi i personave të njëjtë me ID të ndryshme: 25 | 01.2026 deri 06.2026 | Sektori i Kadastrit |
| | | 6.Fshirja e ngarkesës tatimore sipas vendimit të ATK: 2 | 01.2026 deri 06.2026 | Sektori i Kadastrit |
| | | 7.Regjistrimi i hipotekave: 30 | 01.2026 deri 06.2026 | Sektori i Kadastrit |
| | | 8. Regjistrimi i qiramarrjes: 1 | 01.2026 deri 06.2026 | Sektori i Kadastrit |
| | | 9.Fshirja e hipotekës pas skadimit të afatit: 22 | 01.2026 deri 06.2026 | Sektori i Kadastrit |
| | | 10. Modifikimi i të drejtave: 25 | 01.2026 deri 06.2026 | Sektori i Kadastrit |
| | | 11. Shërbimi i të dhënave - nxjerrja e Certifikatës: 850<br>12. Shërbimi i të dhënave Vërtetim që nuk posedon pronë: 441 | 01.2026 deri 06.2026 | Sektori i Kadastrit |
| | | 13.Historiat për parcelat nga Gjeodetë të licencuar dhe Gjykata komunale Gllogoc: 34 | 01.2026 deri 06.2026 | Sektori i Kadastrit |
| | | Në proces për këmbimit të pronës private me pronë komunale kemi tri raste:<br>z. Kad Shtrubullovë: 2 raste,<br>z. Kad Fushticë e Epërme: 1 rast | 01.2026 deri 06.2026 | Sektori i Pronës |
| | | Aktvendime për lirim të pronës komunale 5 rast z.Kad Gllobar: 3 raste, Komoran: 2 raste | 01.2026 deri 06.2026 | Sektori i Pronës |
| | | Kërkesa të ndryshme për dalje në teren: 20. | 01.2026 deri 06.2026 | Sektori i Pronës |

| Nr. rendor | Objektiva | Aktiviteti | Afati | Bartës i aktivitetit |
|---|---|---|---|---|
| -III- Pronë | | Heqje dorë nga pronësia private për dhurim të komunës pa kompensim 1 rast, Z. kad. Gllogoc | 01.2026 deri 06.2026 | Sektori i Pronës |
| | | Menaxhimi i kontratave për pronat komunale të dhëna në shfrytëzim me qira: 12 kontrata. | 01.2026 deri 06.2026 | Sektori i Pronës |
| | | Përgjigje në kërkesat për çasje në dokumente publike: 4 raste. | 01.2026 deri 23.06.2026 | Sektori i Pronës |

**Drenas, Korrik 2026**

**Kryetari i komunës**

Ramiz Lladrovci

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA GLLOGOC - OPŠTINA GLOGOVAC - GLLOGOC MUNICIPALITY